



Instrumenti për Përafrim me Acquis të BE-së

Mbështetje e mëtejme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Nr. identifikues i projektit:

EuropeAid/138565/DH/SER/XK

Kontrata e Shërbimit Nr. 2018/395-320

**UDHËZUES I THJESHTUAR LEHTË I
PËRDORUESHËM PËR KONVENTËN
PAN-EURO MEDITERANE**

Maj Qershor 2019



Personat kontaktues brenda
GFA Consulting Group GmbH janë

Znj.Martina Bernauer (Drejtore e Projektit)
Z.Luis Abugattas (Udhëheqës i ekipit)

Kosovë

Mbështetje e mëtejme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Numri i kontratës 2018/395-320

Raport i ESASH-it

Act 1.2.3 - Udhëzues i Thjeshtuar Lehtë i Përdorueshëm
për Konventën Pan-Euro Mediterane

Autor

Z. Arslan Umut Ergezer

Periudha e raportimit: Maj Qershor 2019

Mohim

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për të pasqyruar pikëpamjet e Bashkimit Evropian

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrogstr. 82
D-22359 Hamburg
Germany

Telefoni: +49 (40) 6 03 06 170
Faxi: +49 (40) 6 03 06 159
E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de

Tabela e Përmbajtjes

1	HYRJE:	1
2	METODOLOGJIA E PËRDORUR:	3
3	KONCEPTI I PRODUKTEVE ME ORIGJINË:	6
4	PËRKUFIZIMET KYÇE PËR T'I DITUR:	9
5	KONCEPTET THEMELORE PËR T'I DITUR NË ZBATIMIN E KUMULIMIT DYPALËSH, DIAGONAL DHE TË PLOTË SIPAS KONVENTËS:	13
5.1	KONCEPTI I NJËSISË SË KLASIFIKIMIT:	13
5.2	RREGULLAT PËR GRUPET	16
6	PASQYRIMI I PROCESIT TË PRODHIMIT DHE ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TË ZBATUAR RREGULLAT E ORIGJINËS	18
7	KUMULIMI DYPALËSH:	24
8	KUMULIMI DIAGONAL:	25
9	KUMULIMI I PLOTË DYPALËSH DHE DIAGONAL:	30
10	KUMULIMI I PLOTË DYPALËSH PËR KAPITUJT 50 DERI 63:	32
11	KUMULIMI I PLOTË DIAGONAL PËR KAPITUJT 50 DERI 63:	38
12	RREGULLA TJERA PËR T'I RESPEKTUAR:	40
12.1	PARIMI I TERRITORIALITETIT:	40
12.2	MOS-NDRYSHIMI:	40
12.3	RREGULLI I PËRGJITHSHËM I TOLERANCËS:	41
12.4	KTHIMI:	41
13	CERTIFIKATA – PROVË APO ORIGJINË	43
13.1	VLEFSHMËRIA E PROVËS SË ORIGJINËS:	47
13.2	DEKLARATA E FURNITORIT:	47
13.3	NDARJA E LLOGARIVE:	49
14	SHTOJCAT:	50

1 HYRJE:

Spaghetti bowl është bërë një nga termet e popullarizuara në tregtinë ndërkombëtare i cili përdoret për të përcaktuar rrjetin e ndërlikuar të marrëveshjeve të tregtisë së lirë ndërmjet vendeve. Vëmendja e politikbërësve dhe publikut të gjerë ka qenë zakonisht në atë nëse janë nënshkruar marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe me kend janë nënshkruar marrëveshjet e tregtisë së lirë.

Mirëpo, sapo të fillojë zbatimi i këtyre marrëveshjeve, ankesat e kompanive, posaçërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat nuk janë shumë të përfshira në tregtinë ndërkombëtare dhe zinxhirin e furnizimit pretendojnë se këto marrëveshje të tregtisë së lirë i promovojnë vetëm importet, por jo edhe eksportet e produkteve vendore.

Realiteti qëndron në protokollet e rregullave të origjinës së marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Protokollet e rregullave të origjinës janë pjesë përbërëse e çdo marrëveshjeje të tregtisë së lirë. Këto protokolle janë ato që përcaktojnë se cilat produkte mund të përfitojnë nga trajtimi preferencial dhe në cilat kushte një marrëveshje e caktuar e tregtisë së lirë do të shtrijë trajtimin preferencial tek mallrat nga vendet e treta.

Sipas skenarit hipotetik, tregtia e liberalizuar e mallrave do të funksionoj në mënyrë të përkryer edhe pa pasur nevojë që të ketë protokoll të rregullave të origjinës nëse të gjitha mallrat e eksportuara tek pala tjetër prodhohen me shfrytëzimin e materialeve që tërësisht e kanë origjinën nga vendi eksportues apo janë importuar nga pala tjetër nënshkruese. Mirëpo, ky skenar në botën e sotme është pothuaj i pamundur përveç për disa produkte siç janë kafshët e gjalla apo produktet e mishit të prodhuara nga kafshët, në veçanti, produktet industriale dhe produktet e përpunuara bujqësore të cilat përfshijnë qindra apo mijëra materiale të ndryshme. Praktikisht është i pamundur ofrimi i të gjitha atyre në një apo dy vende që kanë nënshkruar marrëveshjet e tregtisë së lirë. Për këtë arsye protokollet e rregullave të origjinës jepen përkufizime dhe rregulla të caktuara për produkte se si të shtrihet trajtimi preferencial për mallrat në vendet tjera se në ato që kanë nënshkruar marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe sa do të ishte optimale të kërkohej që përmbajtja e mallrave vendore të prodhohet tek palët nënshkruese të një marrëveshjeje të tregtisë së lirë.

Prandaj ky udhëzues do të ofrojë shpjegime të thjeshtuara dhe lehtë të përdorueshme rreth asaj se si të lexohet dhe kuptohet Konventa Pan-Euro Mediterane (PEM). Arsyeja që Konventa PEM të jetë në qendër të këtij udhëzuesi është se CEFTA (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore) dhe MSA-t (Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit) të nënshkruara me BE-n bazohen në Konventën PEM dhe kanë rregulla identike të origjinës.

Është edhe një arsye tjetër e rëndësishme pse Konventa PEM do të jetë baza e këtij udhëzuesi sepse pritet që Konventa PEM të rishikohet në thelb. Ushtrimi i rishikimit është duke u zhvilluar pothuajse për 10 vjetët e fundit me qëllim që të thjeshtohen rregullat e origjinës në Konventën PEM dhe të ndihmohet lehtësimi i tregtisë rajonale në Zonën Pan-Euro Mediterane. Ushtrimi i rishikimit të Konventës PEM pritet që së shpejti të ketë përfundim të suksesshëm. Ka shumë gjasa që teksti i rishikuar i Konventës PEM të miratohet në verën e vitit 2019 dhe zbatimi do të fillojë menjëherë pas kësaj për palët e saj kontraktuese aktuale.

Ideja për të pasur një konventë rajonale e cila rregullon të gjitha protokollet e rregullave të origjinës të marrëveshjeve të tregtisë së lirë që i janë bashkëngjitur asaj Konvente erdhi në fund të viteve të 1990-ta. Sistemi i kumulimit pan-europian është krijuar midis KE-s, shteteve të EFTA-s¹, vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore dhe shteteve baltike në vitin 1997. Më pas, sistemi i kumulimit Pan-Europian është zgjeruar në Slloveni dhe në produktet industriale me origjinë nga Turqia në vitin 1999. Sistemi përfshin edhe Ishujt Faroa.

Përfshirja e pjesëmarrësve të Procesit të Barcelonës² (në parim vendet në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme) në sistemin e kumulimit ka çuar në krijimin e sistemit të kumulimit Pan-Euro-Mediterran të origjinës në vitin 2005.

Në takimin e Ministrave të Tregtisë Euro-Mediterrane të datës 21 tetor 2007 në Lisbonë u miratua iniciativa e krijimit të një Konvente të vetme PEM, me të cilën do të ndërliken protokollet e rregullave të origjinës për të gjitha marrëveshjet e tregtisë së lirë midis vendeve të lartpërmendura. Krahës kësaj, vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën në kontekst të Procesit të Stabilizim Asocimit, janë përfshirë në tekstin e Konventës së vetme PEM.

Më pas teksti i Konventës PEM (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:L:2013:054:TOC>) u hap për nënshkrim nga secili vend pjesëmarrës. Nënshkruesit e tanishëm të Konventës PEM mund të gjenden në faqen vijuese të internetit të Këshillit të Bashkimit Evropian.

<https://www.consilium.europa.eu/en/documents-publications/treaties-agreements/agreement/?id=2010035>

Sipas listës së fundit, të gjitha Palët Kontraktuese kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën, përpos Sirisë dhe Kosovës. Në rastin e Sirisë, statusi i Sirisë u pezullua si palë kontraktuese për shkak të luftës civile.

Sa i përket Kosovës, emërtimi i përdorur për Kosovën nuk konsiderohet i pranueshëm nga autoritetet e Kosovës dhe për këtë arsye qeveria e Kosovës vazhdon ta mbajë pezull nënshkrimin e Konventës.

Ky dokument udhëzues është i natyrës teknike dhe për këtë arsye nuk përmend asnjë çështje politike në lidhje me Konventën PEM. Për shkak të rishikimit të pritur të tekstit të Konventës së tanishme PEM, udhëzuesi merr parasysh versionin e rishikuar të Konventës PEM sipas versionit të fundit që është në dispozicion të Projektit të BE-s. Versioni i përdorur në këtë udhëzim është i datës 21 shkurt 2019.

Për hir të qartësisë dhe për të ofruar kuptim të strukturuar, nëse ka nevojë, udhëzuesi do t'i referohet edhe termave dhe koncepteve themelore të përdorura në rregullat e origjinës. Nëse është e përshtatshme dhe e pashmangshme, referencat e drejtpërdrejta do të jepen për nenet e Konventës PEM. Së fundi, të gjithë lexuesit këshillohen të shikojnë dokumente të tjera të cilat janë në dispozicion të publikut dhe udhëzuesi i jep vegëzat që t'u mundësohet leximi dhe përditësimi i mëtejshëm.

¹ Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra

² Algjeria, Egjipti, Jordani, Libani, Maroko, Autoriteti Palestinez, Siria, Tunizia dhe Turqia;

2 METODOLOGJIA E PËRDORUR:

Gjatë përgatitjes së këtij udhëzuesi, vëmendja e parë i përkushtohet rregullit dhe më pas se si përputhja me atë rregull do të varet nga lloji i certifikimit. Nëse nevojitet, shpjegohet edhe si dhe çfarë lloji i kontrollit parashikohet për të kontrolluar pajtueshmërinë me këtë certifikim.

Protokollet e rregullave të origjinës, përfshirë Konventën PEM, janë dhe mund të përdoren për objektiva tërësisht tjerë nga akterë të ndryshëm.

Ministritë e përfshira në politikën tregtare, në veçanti ajo e tregtisë dhe bujqësisë, përdorin protokollet e rregullave të origjinës për qëllime politike. Të kuptuarit e tyre mbi protokollet e rregullave të origjinës përqendrohet në përcaktimin e nivelit të qasjes që duhet t'u jepet tregjeve vendore dhe sa qasje do të k

enë në tregjet e eksportit përmes rregullave të origjinës.

Autoritetet Doganore kryesisht zbatojnë rregullat e origjinës për të kontrolluar nëse janë respektuar rregullat nga kompanitë dhe për të monitoruar zbatimin e saktë të rregullave të origjinës, të zbulojnë çdo shkelje të rregullave dhe të shqiptojnë gjopa administrative, nëse është e justifikueshme.

Ndërsa operatorët e bizneseve, si prodhuesit ashtu dhe tregtarët, duhet të kuptojnë rregullat e origjinës për të zbatuar dhe përfutur nga rregullat për biznesin e tyre.

Pra, qëllimi kryesorë i këtij udhëzuesi është të ofrojë gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për ekspertët jo-doganor dhe si mund të zbatohen rregullat nga operatorët e bizneseve. Në këtë drejtim, ndiqet një rrjedhë tjetër logjike se sa rendi i neneve që paraqiten në Konventë. Me përdorimin e kësaj rrjedhe të ristrukturuar logjike, mendohet se operatorët e bizneseve mund të kenë udhëzues më lehtë të përdorueshëm për punën e përditshme.

Për shkak të kufizimeve buxhetore dhe kohore, ky udhëzues nuk jep ndonjë shpjegim të thellë të sektorëve të veçantë, por jep vetëm shpjegim sipërfaqësor. Analiza më e thellë sektoriale mund të kërkojë shpjegime të mëtejshme për çdo aktivitet sektorial.

STRUKTURA KRYESORE E TEKSTIT TË RISHIKUAR TË KONVENTËS PEM (versioni i datës 21 shkurt 2019):

Teksti kryesorë i Konventës PEM:

Teksti kryesorë i Konventës PEM është i shkurtër, sepse përmban vetëm 11 nene. Teksti kryesorë përfshin preambulën, katër pjesë të ndryshme.

Pjesa I është për dispozitat e përgjithshme:

Konventa PEM përcakton dispozitat mbi origjinën e mallrave të tregtuara në kontekst të çdo marrëveshjeje dypalëshe ose rajonale për tregtinë e lirë (Marrëveshjet Relevante) të lidhura ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe ku lidhja midis protokolleve të rregullave të origjinës të këtyre marrëveshjeve relevante dhe Konventës është vendosur zyrtarisht.

Shtojca I e Konventës përmban rregullat e përgjithshme për përkufizimin e konceptit të produkteve me origjinë dhe metodave të bashkëpunimit. (Neni 1.2.)

Ndërsa, Shtojca II përcakton dispozitat apo shmangiet e veçanta nga dispozitat e përgjithshme të cilat janë miratuar para 1 janarit të vitit 2019 dhe zbatohen midis Palëve Kontraktuese.

Shmangia nga parimet e përgjithshme të kumulimit dhe ndalesa e kthimit të tarifës që dalin nga Vendimi 3/2015 i CEFTA-s është njëra nga shmangiet që mund të gjenden në Shtojcën II.

Shmangiet tjera të bëra para vitit 2019 por të papërfshira në Shtojcën II do të mbeten në fuqi, për shkak se Konventa Rajonale nuk ka mandatin të nxjerrë jashtë ligjit ndonjë marrëveshje dypalëshe të dakorduar ndërmjet dy apo më shumë vendeve në mënyrë të pavarur.

Për shkak të transparencës, Neni 1 (3) i Konventës parasheh rregullat që rregullojnë procedurat lidhur me shmangiet e mundshme që do të dakordohen në mënyrë dypalëshe pas 1 janarit 2019.

Prandaj, të gjitha shmangiet nga dispozitat e përgjithshme të Konventës pas 1 janarit 2019 do të duhet të jenë në përputhje me Nenin XXIV të GATT dhe Kryesuesi i Komitetit të Përbashkët do të njoftohet për këtë nga palët që bëjnë shmangien.

Shmangiet mund të hyjnë në fuqi më së largu një muaj pasi informatat mbi shmangiet t'i jenë vënë në dispozicion të Kryesuesit të Komitetit të Përbashkët.

Kryesuesi i Komitetit të Përbashkët i njofton Palët tjera Kontraktuese mbi pranimin e informatave mbi shmangiet dhe afatin kohor kur ato hyjnë në fuqi.

Shënim i Rëndësishëm:

- 1) Procedurat për dispozitat dhe shmangiet e veçanta janë të rëndësishme sepse Konventa e rishikuar parasheh zgjerimin e kumulimit të plotë diagonal në Kapitujt 50 deri 63 (tekstili dhe veshjet) me kusht që të arrihet marrëveshja dypalëshe ndërmjet dy Palëve Kontraktuese mbi dispozitat e veçanta.**
- 2) Është e rëndësishme të theksohet se kërkesa e parashikuar me Nenin 1(3) nuk është kërkesë për miratim, por vetëm informatë për të shtuar transparencën. Kjo nënkupton se çdo marrëveshje dypalëshe ndërmjet dy Palëve Kontraktuese me qëllim të zgjerimit të kumulimit të plotë në Kapitujt 50-63 do të duhet të kërkojë miratimin nga Palët tjera kontraktuese të Konventës PEM. Mirëpo, do të ketë vetëm kërkesë që Kryesuesit të Komitetit të Përbashkët t'i dërgohen informatat e nevojshme mbi marrëveshjen dypalëshe të dispozitave apo shmangieve të veçanta, me periudhë pritjeje prej minimum 1 muaj + 1 ditë para se dispozitat e veçanta të hyjnë në fuqi.**

Pjesa II është për dispozitat lidhur me Komitetin e Përbashkët:

- Rregulli për vendim marrje në Konventën PEM:**

Rregulli kryesorë i vendim marrjes është unanimiteti. Sipas Nenit 3(2), Komiteti i Përbashkët i Konventës PEM vepron me unanimitet përveç në rastet e aderimit të palëve të reja ku do të zbatohet konsensusi minus dy.

Komiteti i Përbashkët ka mandatin të miratojë vendime me unanimitet për të ndryshuar apo plotësuar Konventën, të ftojë palët e treta të aderojnë në Konventë dhe masat kalimtare për pranimin e palëve të reja kontraktuese.

Vendimet e miratuara nga Komiteti i Përbashkët i Konventës PEM do të hyjnë në fuqi sipas legjislacionit kombëtar të çdo Pale Kontraktuese.

Shënim i Rëndësishëm:

- 1) Çdo ndryshim i Konventës, përfshirë preambulën e saj, kërkon unanimitet nga Komiteti i Përbashkët.***

Pjesa III për dispozitat lidhur me Aderimin e Palëve të Treta:

- Rregulli për aderim në Konventën PEM:

Çdo vend mund të bëhet Palë Kontraktuese, nëse vendi ose territori kandidat ka një marrëveshje për tregti të lirë në fuqi, e cila parasheh rregullat preferenciale të origjinës me së paku një Palë Kontraktuese.

Duhet që ai vend i cili dëshiron t'i bashkohet Konventës PEM t'i parashtoj një kërkesë me shkrim Komitetit të Përbashkët përmes depozituesit.

Pjesa IV përfshin dispozitat e ndryshme dhe përfundimtare. Ndër të tjera, Neni 8 parashikon që Shtojcat e Konventës të formojnë një pjesë përbërëse të Konventës. Dhe Neni 11 thotë se Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian vepron si depozitues i Konventës.

3 KONCEPTI I PRODUKTEVE ME ORIGINË

Shtojca I e Konventës jep përkufizimin e konceptit të produkteve me origjinë dhe metodave të bashkëpunimit administrativ. Ajo ndahet në tetë tituj të ndryshëm. Shtojca I i ka edhe tetë anekse.

Sa i përket strukturës së titujve të Shtojcës I, Neni 1 në Titullin I jep përkufizime qenësore të disa termeve vendimtare për zbatim të Konventës.

Rregullat për zbatimin e Konventës përcaktohen me nenet e parashikuara në Titujt II (Përkufizimi i Konceptit të Produkteve me Origjinë), III (Kërkesa Territoriale), dhe IV (Kthimi apo Përrjashtimi).

Nën Titullin V përcaktohen procedurat mbi atë se si të merret certifikata për të dëshmuar origjinën preferenciale të mallrave.

Titulli VI parashikon çfarë dokumente dhe dëshmi plotësuese duhet të sigurohen dhe kontrollohen për të vërtetuar certifikimin mbi origjinën preferenciale (prova e origjinës).

Titulli VII i përkushtohet bashkëpunimit administrativ ndërmjet autoriteteve doganore dhe procedurave që duhet të ndiqen për vërtetim të certifikatave (qofshin prova të origjinës apo deklaratë e furnitorit).

Titulli i fundit është për zbatim të protokollit në zona dhe territore të ndryshme ekonomike siç janë ZEE, Lihtenshtajni, San Marino, Andora dhe Ceuta dhe Melilla.

Aneksi II jep rregullat e veçanta për produkte të cilat vendosin kriteret apo pragjet për të përcaktuar origjinën preferenciale të mallrave; jo tërësisht të përfituar por që i nënshtrohen një punimi dhe përpunimi të mjaftueshëm.

Aneksi I ka të bëjë me shënimet shpjeguese që lidhen me rregullat e veçanta në Aneksin II.

Aneksi III jep tekstin e deklaratës së origjinës që do të përdoret kur nuk kërkohet certifikata e qarkullimit 1 EUR.

Aneksi IV parashikon ekzemplarët e certifikatës së qarkullimit 1 EUR dhe kërkesën për certifikatë të qarkullimit EUR 1.

Aneksi V është për kushte të veçanta për produktet me origjinë nga Ceuta dhe Melilla.

Aneksi VI dhe VII jep formatin e shabllonit të deklaratës, gjegjësisht të deklaratës afatgjatë të furnitorit.

Aneksi VIII është i rezervuar për listën e Palëve Kontraktuese, të cilat do të vendosin për zgjerim të kumulimit të plotë diagonal për Kapitujt 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

Shtojca I

PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË 'PRODUKTEVE ME ORIGJINË' DHE METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

PËRMBAJTJA

TITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

TITULLI II PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË PRODUKTEVE ME ORIGJINË Neni 2 Kërkesat e përgjithshme

Neni 3 Produkte të prodhuara tërësisht

Neni 4 Puna ose përpunimi i mjaftueshëm

Neni 5 Rregulli i tolerancës

Neni Puna ose përpunimi i pamjaftueshëm

Neni 7 Kumulimi i origjinës

Neni 8 Kumulimi i origjinës – Kushtet për zbatimin e tij

Neni 9 Njësia e kualifikimit

Neni 10 Grupet

Neni 11 Elementet neutrale

Neni 12 Ndarja e kontabilitetit

TITULLI III KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 13 Parimi i territorialitetit

Neni 14 Mosndryshimi

Neni 15 Ekspozitat

TITULLI IV KTHIMI APO PËRJASHTIMI

Neni 16 Ndalesa e kthimit apo përjashtimit të tarifës

TITULLI V PROVA E ORIGJINËS

Neni 17 Kërkesat e përgjithshme

Neni 18 Kushtet për dhënie të deklaratës së origjinës

Neni 19 Eksportuesi i aprovuar

Neni 20 Procedura për lëshim të certifikates së qarkullimit EUR.1

Neni 21 Certifikatat e qarkullimit EUR.1 të lëshuara me efekt prapaveprues

Neni 22 Lëshimi i certifikatës dublikatë të qarkullimit EUR.1

Neni 23 Vlefshmëria e proves së origjinës

Neni 24 Zonat e lira

Neni 25 Kërkesat për importim

Neni 26 Importimi me këste

Article 27 Exemption from proof of origin

Article 28 Discrepancies and formal errors

Article 29 Supplier's declarations

Article 30 Amounts expressed in euro

TITLE VI PRINCIPLES OF COOPERATION AND DOCUMENTARY EVIDENCE

Article 31 Documentary evidence, preservation of proofs of origin and supporting documents

Article 32 Dispute settlement

TITULLI VII BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 33 Njoftimi dhe bashkëpunimi

Neni 34 Vërtetimi i provave të origjinës

Neni 35 Vërtetimi i deklaratave të furnitorit

Neni 36 Gjobat

TITULLI VIII ZBATIMI I PROTOKOLLIT

Neni 37 Zona Ekonomike Evropiane

Neni 38 Lihtenshtajni

Neni 39 Republika e San Marinos

Neni 40 Principata e Andorës

Neni 41 Ceuta dhe Melilla

Lista e Anekseve

ANEKSI I: Shënimet hyrëse në listen në Shtojcën II

ANEKSI II: Lista e punimit apo përpunimit që do të kryhet për materialet pa origjinë me qëllim që produkti i prodhuar të marrë statusin e origjinës

ANEKSI III: Teksti i deklaratës së origjinës

ANEKSI IV: Mostrat e certifikatës së qarkullimit EUR.1 dhe aplikimi i certifikatës së qarkullimit EUR.1

ANEKSI V: Kushtet e veçanta lidhur me produktet me origjinë nga Ceuta dhe Melilla

ANEKSI VI: Deklarata e furnitorit


ANEKSI VII: Deklarata afatgjatë e furnitorit

ANEKSI VIII: Lista e Palëve Kontraktuese of Contracting Parties që kanë zgjedhur të zgjerojnë zbatimin e Nenit 7, paragrafi 3 për importimin e produkteve që bëjnë pjesë në Kapitujt 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar

4 PËRKUFIZIMET KYÇE PËR T'I DITUR

- 1) **Mallrat, produktet dhe materiali:** Sipas tekstit të rishikuar të Konventës, **mallrat** nënkuptojnë si materialet, ashtu edhe produktet. Konventa i përkufizon **produktet** si një produkt i prodhuar, edhe nëse është destinuar për përdorim të mëvonshëm në një operacion tjetër prodhimi. Ndërsa, **materiali** përmban çdo përbërës, lëndë të parë, komponent apo pjesë të përdorur në prodhimin e produktit.

Me përkufizimet e lartpërmendura, grafiku në vijim paraqet marrëdhëniet hierarkike midis mallrave, produkteve dhe materialeve.



Shënim: Për shkak të thjeshtimit të përshkrimeve dhe për të lehtësuar të kuptuarit e koncepteve kryesore të Konventës, jogurti me shije të pemëve do të përdoret si shembulli kryesor për pjesën tjetër të dokumentit sa është e zbatueshme.

- 2) **Vlera doganore:** Sipas Konventës, vlera doganore nënkupton vlerën siç është përcaktuar me Marrëveshjen e OBT-s për Vlerësimin Doganor.

Si parim i përgjithshëm, vlera doganore e mallrave të importuara (përfshin produktin apo materialin) është vlera e transaksionit.

Vlera e transaksionit nënkupton çmimin real të paguar ose të pagueshëm për mallrat kur shiten për eksport në vendin e importimit të përshtatur në përputhje me dispozitat vijuese (Neni 8 i Marrëveshjes së OBT mbi Vlerësimin).

Çmimit real të pagesës apo të pagueshëm për mallrat e importuara i shtohen si në vijim:

A

- Komisionet dhe provizionet e ndërmjetësit, përveç komisioneve për blerje;
- Kostoja e kontejnerëve që trajtohen si ato të cilave u caktohet dogana për mallrat përkatëse

Dhe me mallrat përkatëse

- Kostoja për paketim për punë apo materiale.

(tre pikët e lartpërmendura mund të shtohen në atë masë që ato të jenë blerë nga blerësi, por nuk janë përfshirë në çmimin që realisht paguhet ose është i pagueshëm për mallrat)

B

Vlera proporcionale sipas rastit, e mallrave dhe shërbimeve në vijim të furnizuara drejtpërdrejtë apo tërthorazi nga blerësi pa pagesë ose me kosto të reduktuar për përdorim në lidhje me prodhimin dhe shitjen e eksporteve të mallrave të importuara, për aq sa vlera e tillë nuk është përfshirë në çmimin real të paguar apo të pagueshëm:

- Materialet, komponentet, pjesët dhe artikujt e ngjashëm të përfshirë në mallrat e importuara
- Veglat, ngjyrat, kallëpet dhe artikujt e ngjashëm në prodhimin e mallrave të importuara,
- Materialet që konsumohen në prodhimin e mallrave të importuara;
- Inxhineria, zhvillimi, veprat artistike, projektimi, planet dhe skicat, të bëra diku tjetër e jo në vendin e importimit dhe të nevojshme për prodhime të mallrave të importuara
- Tantiemat dhe tarifat e licencave për mallrat për të cilat vlerësohet se duhet të paguajë blerësi, qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi, si kusht i shitjes apo i mallrave që vlerësohen, për aq sa tantiemat dhe tarifat e tilla nuk përfshihen në çmimin që realisht paguhet apo është i pagueshëm,
- Vlera e çdo pjesë të të ardhurave nga çdo rishitje, deponim apo përdorim të mëpasshëm të mallrave të importuara që është në dobi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të shitësit

C

- Çdo anëtar i OBT-s parashikon në legjislacionin e tij përfshirjen apo përjashtimin nga vlera doganore, në tërësi ose pjesërisht, si në vijim:
- Koston e transportit të mallrave të importuara në port apo vendin e importimit;
- Pagesat për ngarkim, shkarkim dhe trajtim që lidhen me transportin e mallrave të importuara në port apo vend të importimit; dhe
- Koston e sigurimit

Në parim, kjo është vlera CIF (kosto, sigurimi dhe transporti).

Nëse ato që u cekën më lartë i paguan blerësi, vlera është FOB (Pa pagesë në anije) vlerë që nënkupton vlerën e mallrave pa kosto, sigurim dhe transport.

Si përfundim, vlera do të ishte ose A+B ose A+B+C sipas legjislacionit kombëtar.

Më shumë informata të detajuara dhe teksti i plotë i Marrëveshjes mbi Vlerësimin Doganor të OBT-s mund të gjenden në faqen vijuese të internetit.

https://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/20-val_01_e.htm

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Vlera doganore është ndryshe nga çmimi franko.

3) Çmimi **franko** nënkupton çmimin franko të fabrikës që i paguhet prodhuesit nga Pala Kontraktuese ku punimi apo përpunimi i fundit kryhet me kusht që çmimi të përfshijë

- a. Vlerën e të gjitha materialeve plus
- b. Të gjitha kostot tjera që lidhen me produktet e saj siç është inxhinieringu, zhvillimi, tantimat e paguara, kostoja e punës etj. minus
- c. Të gjitha taksat e brendshme që do të paguheshin kur produkti i marrë eksportohet

Nëse punimi apo përpunimi i nënkontraktohet prodhuesit, prodhuesi duhet të pranohet si ndërmarrje që e ka punësuar nën-kontraktuesin.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Nëse çmimi real i paguar nuk paraqet të gjitha shpenzimet lidhur me prodhimin e produktit që janë realisht të shkaktuara tek Pala Kontraktuese, çmimi franko i fabrikës pranohet sipas përkufizimit të mësipërm: të gjitha shpenzimet e shkaktuara për prodhim minus taksat e brendshme.

ÇMIMI FRANKO < FOB < CIF

4) **Materialet e zëvendësueshme apo produktet e zëvendësueshme (fungible)** nënkuptojnë materialet apo produktet që janë të një lloji dhe cilësie tregtare, me veçori të njëjta teknike dhe fizike dhe të cilat nuk mund të dallohen nga njëri tjetri.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Përkufizimi i materialeve të zëvendësueshme është i rëndësishëm për zbatimin e ndarjes së llogarive sipas Nenit 12 të Konventës. Vini re se është fituar statusi i origjinës preferenciale në çdo marrëveshje të tregtisë së lirë, të nënshkruar nga vendet. Prandaj, materialet e njëjta mund të pranohen si materiale me origjinë sipas një marrëveshjeje të tregtisë së lirë në rast se janë plotësuar të gjitha rregullat e nevojshme të rregullave të Marrëveshjes së protokollit të origjinës, përderisa mund të mos pranohet për një marrëveshje tjetër të tregtisë së lirë të cilën e ka nënshkruar shteti i njëjtë.

Për sektorin e biznesit, është me rëndësi të kuptohet Neni 12 i Konventës dhe të plotësohen të gjitha kërkesat e parashikuara për të përfituar nga lehtësimet e ofruara nga ai nen nëse materialet apo produktet e njëjta tregtohen me partnerë të ndryshëm të tregtisë së lirë të Kosovës.

- 5) **Vlera e shtuar** do të pranohet në zbatimin e neneve të Konventës për kumulimin, si çmimi franko i produktit minus vlera doganore e secilit nga materialet (dhe/apo produkteve) të inkorporuara, me origjinë nga Pala tjetër Kontraktuese me të cilat zbatohet kumulimi.
- 6) **Territori** nënkupton territorin e tokës, ujërat e brendshme dhe detin territorial të një Pale Kontraktuese.

5 KONCEPTET THEMELORE PËR T'I DITUR NË ZBATIMIN E KUMULUMIT DYPALËSH, DIAGONAL DHE TË PLOTË SIPAS KONVENTËS

Siç u përmend në metodologji, udhëzuesi së pari do të jep rregullin që do të zbatohet në çdo koncept dhe si do të duhet të certifikohet patjueshmëria me rregull të veçantë dhe çfarë kontrole dhe monitorime të mundshme mund t'i kryejnë autoritetet doganore.

Për të siguruar udhëzues të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshëm zbatohet logjika e operatorit të biznesit.

Për ta kuptuar tërë konceptin e origjinës preferenciale të parashikuar me Konventë, operatori së pari duhet të sigurohet rreth klasifikimit tarifor të mallrave të tij të prodhuara dhe të gjitha produkteve dhe materialeve tjera të përfshira.


Për shkak të thjeshtimit, do të vazhdohet të përdoret shembulli i jogurtit:

5.1 KONCEPTI I NJËSISË SË KLASIFIKIMIT:

RREGULLI: Njësia e kualifikimit për zbatimin e Konventës është produkti i posaçëm i cili konsiderohet si njësi bazë kur përcaktohet klasifikimi tarifor me përdorim të nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Është me rëndësi vendimtare të specifikohet kodi tarifor i atij produkti të posaçëm për të cilin operatori i biznesit do të kërkojë t'i zbatojë dispozitat e Konventës. Mospërcaktimi specifik i kodit tarifor apo ndonjë gabim që mund të ndodhë në përcaktimin e kodit tarifor mund të çojë në interpretim të gabueshëm të Konventës.

Shembulli: 0403.10 është kodi i nën-kreut të jogurtit. Sipas TARIC të BE në përputhje me Sistemin e Harmonizuar, ai përfshin si jogurtin e paaromatizuar, ashtu edhe atë që nuk përmban fruta të shtuara, si dhe atë të aromatizuar dhe që përmban fruta të shtuara. Në rast nevojë, kodi i SH të nivelit të produktit mund të përcaktohet nëse ekziston kodi i nivelit të produktit 8 shifror. Është me rëndësi të theksohet se 8 shifrorët akoma i janë lënë çdo vendi për t'i përcaktuar sipas nevojave kombëtare, duke respektuar klasifikimin ndërkombëtar të SH-s të parashikuar për 6 shifrorët.



RREGULLI: Kërkon që në rast se produkti që përbëhet nga një grup apo një grup artikujsh të klasifikohet në një krerë të vetëm, i tëri përbëhet nga njësia e klasifikimit.

Kjo është shumë më e zbatueshme për produktet industriale.

Shembull: Të shkruarit e përmbledhjeve të klasifikuara nën 4817.30 mund të jenë shembull i mirë për klasifikimin e llojeve të ndryshme të letrave nën nën-krerë të njëjtë; kjo do të përdoret si njësi kryesore e e klasifikimit për të zbatuar Konventën.

Përderisa një dërgesë përfshin disa produkte identike të klasifikuara nën kreun e njëjtë të SH-s, gjatë zbatimit të Konventës merret parasysh çdo njësi e veçantë.

Shembulli: Nëse dërgesa përfshin produkte identike, jogurtin e klasifikuar nën 0403.10 si shembull, çdo produkt do të merret parasysh veç e veç qofshin rregullat e origjinës preferenciale të zbatueshme apo jo. Logjika është për të qenë të sigurt rreth natyrës identike të produkteve me qëllim të klasifikimit tarifar, e kjo do të ishte e zbatueshme edhe për qëllime të rregullave të origjinës.

Në rastin e jogurtit, edhe pse Konventa për tërë Kapitullin 04 nuk parasheh ndonjë rregull tjetër për produkte të veçanta, kreu 0403 përfshin shumë lloje të ndryshme të produkteve të qumështit të fermentuar.

RREGULLI: Nëse ambalazhimi përfshihet në klasifikimin e produktit sipas Rregullit 5 të Përgjithshëm të Sistemit të Harmonizuar, ai do të përfshihet edhe për qëllime të origjinës.

Shkurtimisht, rregullat e përgjithshme për interpretim të Sistemit të Harmonizuar përcaktojnë që kutitë si kutitë e kamerave, kutitë e instrumenteve muzikore, etj dhe kontenierët e ngjashëm të cilëve u është dhënë formë e veçantë apo janë përshtatur për të mbajtur një artikull apo një grup artikujsh të caktuar, do të klasifikohen kur zakonisht shiten në atë kuti apo kontenier.

Shembulli: Në rastin e jogurtit me shije frutash, enët apo filxhanët që përmbajnë jogurt nuk do të merren parasysh për qëllime klasifikimi si dhe për përcaktimin e origjinës së produktit sipas Konventës.



SHËNIM I RËNDËSISHËM: Derisa RP 5 thotë që materialet e ambalazhimit dhe kontenierët e ambalazhimit të paraqitur me mallra në to klasifikohen me mallra, me kusht që ato janë të atij lloji që zakonisht përdoren për ambalazhim të mallrave. Mirëpo, kjo nuk është e detyrueshme kur materiali apo kontenieri i tillë i ambalazhimit është qartë i përshtatshëm për përdorim të përsëritur. Kjo do të thotë që materiali apo kontenieri i ambalazhimit me përdorim të përsëritur ose i cili nuk është i llojit që zakonisht përdoret për ambalazhim të mallrave mund të klasifikohet veç e veç. Në këtë rast, këto materiale të ambalazhimit do të vlerësohen veç e veç me qëllim të përcaktimit të origjinës.

Shembulli: Një artikull luksoz si parfumi i cili mund të jetë i ambalazhuar në kontenier të artë klasifikohet nën titujt tjerë sipas RP 5. Përdërisa parfumet klasifikohen nën Titullin 3303.00, dhe kontenieri i tij prej ari, klasifikohet nën kreun 7113.19.



RREGULLI: aksesorët, pjesët rezervë dhe veglat që vijnë së bashku me një pjesë të pajises, makinës, aparatit apo automjetit, të cilat janë pjesë e pajisjes së rëndomtë dhe të përfshira në çmimin e tyre franko, pranohen si pjesë e pajisjes, makinës, aparatit apo automjetit përkatës.

Shembulli: Një gomë rezervë që vjen me makinë nuk klasifikohet ndarazi, por pranohet si pjesë e makinës për përcaktim të klasifikimit dhe origjinës.



5.2 RREGULLAT PËR GRUPET

Para përkufizimit të konceptit të produkteve me origjinë, çdo operator biznesi duhet t'i kushtojë vëmendje rregullave për grupet.

RP 3 jep udhëzime për rastet kur produkti mund të klasifikohet nën dy apo më shumë krerë. Në këto raste, rregulli i parë është t'i jepet përparësi kreu i cili jep përshkrime më specifike të krerëve, duke dhënë përshkrim më të përgjithshëm.

Nëse bëhet fjalë për mallrat e përbëra të cilat përbëhen nga materiale të ndryshme ose janë prodhuar nga komponentë të ndryshëm, si dhe mallrat që janë bashkuar si grupe për shitje me pakicë, të cilat nuk mund të klasifikohen sipas paragrafit të lartpërmendur, ato klasifikohen sikur të përbëheshin nga materiali që u jep atyre karakterin themelor.

Nëse që të dy paragrafët e lartpërmendur nuk janë të zbatueshëm, përparësi ka kreu i cili jep përshkrimin më specifik.

RREGULLI: Nëse produktet që bëjnë pjesë në përkufizimin e grupeve në përputhje me RP 3 të Sistemit të Harmonizuar konsiderohen se kanë origjinë preferenciale kur të gjitha produktet përbërëse janë me origjinë.


RREGULLI: Në rast se një grup përbëhet nga produktet me origjinë dhe pa origjinë, grupi si tërësi konsiderohet me origjinë me kusht që vlera e produkteve pa origjinë **nuk tejkalon 15% të çmimit franko të grupit.**

Shembulli: Fotoja më poshtë është një grup lodrash, ku përfshihet një kukull nga plastika, një furrë lodër e bërë nga plastika dhe brumi për lojë. Grupi është plasuar për shitje me pakicë si ambalazhi i paraqitur më poshtë.



Pasi të zbatohet rregulli i parë i RG 3 i lartpërmendur, ne do të duhet të shikojmë nëse ekziston ndonjë krerë i veçantë, i cili mund të jep përshkrim më specifik krahasuar me krerët e tjerë. 9503 është kreu më specifik, i cili në veçanti përkufizon kukullat. Më pas, 9503.00.70 është realizuar për lodrat që janë vendosur në grupe.

Në rast se produkti është përkufizuar në mënyrë të detajuar dhe është fituar kodi tarifor për produktin, mund të arrijmë në një fazë të vlerësimit nëse produkti përkatës mund të ketë origjinë preferenciale sipas Konventës. Në vijim është dhënë diagrami për të shfaqur diagramin e rrjedhës logjike të rregullave kur vendoset klasifikimi i produkteve dhe fazat vijuese pas klasifikimit për të përcaktuar origjinën.



6 PASQYRIMI I PROCESIT TË PRODHIMIT DHE ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TË ZBATUAR RREGULLAT E ORIGINËS

Siç shihet në diagramin e mësipërm, pas vendosjes së klasifikimit tarifor të produktit përkatës, ne do të duhet të shikojmë procesin e prodhimit me rregullat e përcaktimit të origjinës. Prandaj, operatori duhet të jetë plotësisht në dijeni mbi të gjitha hollësitë e procesit të tij të prodhimit dhe zinxhirit të furnizimit. Për të shfrytëzuar tërësisht përparësitë e protokollit të origjinës së rrjetit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të cilat i ka një shtet, biznesi duhet të analizojë thellë si procesin e tij të prodhimit, ashtu edhe zinxhirët e furnizimit.


Procesi i prodhimit do të jep informata mbi përbërjen dhe burimet e materialeve që përfshihen në produktin final, si dhe llojet e punimit dhe përpunimit. Ndërkaq, analiza e zinxhirit të furnizimit do të bënte që të kuptoheshin më mirë çështjet e mundshme lidhur me burimin, qoftë të materialeve apo ofrimin e shërbimeve, si punimi dhe përpunimi. Në fund, të gjitha rregullat e origjinës duhet të merren parasysh bashkë me masat teknike, sanitare dhe fito-sanitare, që ndonjëherë janë zbatuar dhe çështjet e tjera të lehtësimit tregtar dhe të transportit nëse qëllimi është optimizimi i zinxhirit të furnizimit.

Për shkak të thjeshtimit, udhëzuesi do të vazhdojë t'i referohet prodhimit të jogurtit për të shpjeguar konceptet e produktit tërësisht të përfituar, punimit apo përpunimit të mjaftueshëm dhe kumulimit dypalësh dhe diagonal. Mirëpo, meqë procesi i prodhimit të veshjeve bën që të kuptohet më mirë kumulimi i plotë, ky proces do të përdoret si shembull për të shpjeguar kumulimin dypalësh dhe diagonal.

Proceset kryesore prodhuese të prodhimit të jogurtit:

Sipas informatave që gjenden në web faqen sektoriale mbi qumështin dhe produktet e qumështit, fazat e mëposhtme njihen si proceset kryesore të jogurtit:

- Përshtatja e përbërjes së qumështit për të arritur përmbajtjen e dëshiruar të yndyrës dhe lëndëve të ngurta dhe përbërësit e përzierjes (siç janë stabilizuesit)
- Pasterizimi i qumështit/ Trajtimi i lartë
- Homogjenizimi për të përzierë të gjithë përbërësit
- Ftohja e qumështit
- Inokulimi me kulturat fillestare (siç janë *Lactobacillus bulgaricus* dhe *Streptococcus thermophilus*)
- Mbajtja për të arritur nivelin e dëshiruar të pH-s për të mundësuar fermentimin
- Ftohja për të ndërprerë procesin e fermentimit
- Shtimi i frutave dhe shijes
- Ambalazhimi



Siç është përshkruar më lartë, prodhuesi duhet të jetë i sigurt për kodin tarifor të produktit(eve) të tij i cili do të prodhohet sipas Sistemit të Harmonizuar.


Jogurti klasifikohet nën HS 0403.10 si nënkrye. Sipas llojeve të shijeve dhe përqindjes së yndyrës, ekzistojnë kodet e SH për nivelin e produkteve të cilat nuk do të përdoren për këtë udhëzues, përveç nëse nevojitet.

Sipas Konventës së rishikuar, rregulli për specifika të produkteve siç është cekur në Aneksin II të Konventës së rishikuar është si në vijim:

Kreu SH	Përshkrimi i produktit	Punimi apo përpunimi, i kryer në materialet pa origjinë, të cilat japin statusin me origjinë
Kapitulli 4	Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër	Prodhimi ku të gjitha materialet e përdorura të Kapitullit 4 janë tërësisht të përfituara

Rregulli nënkupton se materialet e përdorura në prodhimin e jogurtit që janë klasifikuar nën Kapitullin 4 duhet të jenë tërësisht të përfituara, ndërsa materialet tjera mund të furnizohen nga vendet e tjera (materialet pa origjinë).

Në rastin e jogurtit, materialet që përdoren për prodhimin e tij janë si në vijim:



- Qumështi (SH 0401)
- Fruti (p.sh. dredhëza SH 0810.10) apo lëngu i frutave (p.sh. lëngu i dredhëzës SH 2009.50)
- Sheqeri (SH 1701) (nëse nevojitet)
- Rrëshira (SH 1301)
- Bakteret (SH3002)
- Gjelatina (SH 3503)

Sipas rregullit për specifika të produkteve të jogurtit, qumështi, i cili është material i vetëm i klasifikuar nën Kapitullin 4, duhet të jetë tërësisht i përfituar.

Cilat janë kushtet për të qenë produkt tërësisht i përfituar?

Kushtet për të qenë produkte tërësisht të përfituara janë renditur në Nenin 3 të Aneksit I të Konventës së rishikuar.

Neni 3

Produkte të përfutuara plotësisht

1. Konsiderohen të përfutuara plotësisht në një palë kontraktuese nëse eksportohet në një palë tjetër kontraktuese si më poshtë:
 - a) produktet minerale dhe uji natyral të nxjerrë nga toka dhe nga shtrati detar i saj;
 - b) bimët, përfshirë bimët ujore dhe produktet e perimeve të kultivuara apo të vjela atje;
 - c) kafshët e gjalla të lindura dhe mbarështuara atje;
 - d) produktet nga kafshët e gjalla të mbarështuara atje;
 - e) produktet nga kafshët e therura të lindura dhe të mbarështuara atje;
 - f) produktet e përfutuara gjatë gjahut dhe peshkimit të zhvilluar atje;
 - g) produktet e akuakulturës, ku peshqit, krustaqet, molusqet dhe jovertebrorët tjerë janë lindur dhe rritur atje nga vezët, larvat e tyre ose peshku i sapoçelur ose peshqit e vegjël;
 - h) produktet nga peshkimit në det ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të palës kontraktuese eksportuese me mjetet lundruese të saj;
 - i) produktet e bëra në bordin e anijeve të saj fabrika vetëm nga produktet e përmendura në (h)
 - j) artikujt e përdorur të marrë atje që janë të përshtatshëm vetëm për përfutimin e lëndëve të para;
 - k) mbeturinat dhe skrapi që mbeten nga operacionet e prodhimit të zhvilluara atje;
 - l) produktet e nxjerra nga toka ose nëntoka detare jashtë ujërave të saj territoriale, por me të drejta ekskluzive të shfrytëzimit;
 - m) mallrat e prodhuara atje vetëm nga produktet e përcaktuara në (a) deri (l).
2. Termat “anijet e saj” dhe “anijet fabrika të saj” në paragrafët 1(h) dhe (i) zbatohen vetëm për mjetet lundruese dhe anijet fabrika, të cilat i plotësojnë secilin nga kushtet vijuese:
 - a) janë regjistruar në palën kontraktuese eksportuese ose importuese;
 - b) lundrojnë nën flamurin e palës kontraktuese eksportuese ose importuese;
 - c) c) plotësojnë njërin nga kushtet në vijim:
 - i) të paktën 50% janë në pronësi nga shtetas të palës kontraktuese eksportuese ose palës kontraktuese importuese ose
 - ii) janë në pronësi të kompanive
 - me seli dhe vendin kryesor të biznesit në palën kontraktuese eksportuese ose importuese dhe
 - të paktën 50% janë në pronësi të palës kontraktuese eksportuese ose organeve publike apo shtetasve të këtxre palëve;
3. Për qëllime të paragrafit 2, nëse pala kontraktuese eksportuese është Bashkimi Europian, kjo nënkupton shtetet anëtare të Bashkimit Europian.
4. Për qëllime të paragrafit 2, shtetet e EFTA-s konsiderohen si një palë kontraktuese.

RREGULLI: Për rastin e veçantë të qumështit, qumështi duhet të prodhohet nga kafshët e kultivuara tek Pala Kontraktuese ku prodhimi i jogurtit bëhet sipas rregullit për specifika të produkteve.

Rregulli nuk kërkon që qumështi duhet të prodhohet nga kafshët e lindura atje.

Rregulli lejon importimin e kafshëve që kanë lindur në një shtet tjetër me një moshë të re tek pala kontraktuese Mirëpo, këto kafshë të reja duhet të kultivohen tek ajo palë kontraktuese ku do të prodhohet qumështi.

Nëse, prodhimi i jogurtit do të bëhet tek Pala e njëjtë Kontraktuese ku qumështi është tërësisht i përfituar, atëherë, jogurtit do t'i jepet origjina preferenciale, prodhimi i të cilit bëhet me qumështin e prodhuar në vendin e njëjtë.

Por duhet theksuar se statusi i origjinës preferenciale i një produkti të caktuar është i disponueshëm vetëm në tregtinë dypalëshe të atij produkti (p.sh. jogurti i prodhuar tek njëra nga Palët Kontraktuese) ndërmjet një Pale Kontraktuese tek Pala tjetër Kontraktuese sipas kushteve në vijim:

- Marrëveshja Dypalëshe apo Rajonale e Tregtisë së Lirë (siç është CEFTA apo MSA-t e BE)
- Rregullat identike të origjinës që do të zbatohen në marrëveshjet përkatëse të tregtisë së lirë (siç janë CEFTA dhe MSA-t)

Por, kur planifikohet procesi i prodhimit i orientuar në eksport, përpos rregullave të origjinës duhet të kontrollohen edhe rregullat teknike dhe SFS, që janë specifike për një produkt të caktuar.

Të supozojmë se qumështi prodhohet nga kafshët e kultivuara në njërën nga Palët e CEFTA-s. (Për shembull: Kosovë)

Të supozojmë gjithashtu se qumështi, tërësisht i përfituar në Kosovë, përdoret edhe për prodhimin e jogurtit në Kosovë dhe planifikohet të eksportohet në BE.

Është e pamundur të realizohet një eksportim i tillë, sepse jogurti i prodhuar në Kosovë, i cili është prodhuar nga qumështi tërësisht i përfituar në Kosovë, nuk i plotëson standardet e nevojshme veterinarë të BE-s. Prandaj, edhe nëse ai mund të fitoj statusin e origjinës preferenciale sipas rregullave të origjinës, eksporti nuk do të mund të destinohet për BE.

Por, nëse standardet e SFS janë ndryshe në njërën apo më shumë Palë të CEFTA-s se ato që kërkohen nga BE-ja, një tregti e tillë dypalëshe mund të ndodhë ndërmjet Kosovës dhe Palës tjetër të CEFTA-s. Për shembull, jogurti i prodhuar nga qumështi që është përfituar tërësisht në Kosovë, mund të eksportohet në Shqipëri me origjinë preferenciale.



7 KUMULIMI DYPALËSH:

Nëse supozojmë se nuk ka mjaft prodhim të qumështit në Kosovë për të plotësuar kërkesën e jogurtit që vjen nga Shqipëria, atëherë prodhuesi në Kosovë mund të konsiderojë të importojë qumështin qoftë nga Shqipëria apo ndonjë Palë tjetër e CEFTA-s për të mbajtur rregullin specifik për origjinën e produktit i cili është plotësuar për qumësht (gjegj. tërësisht i përfituar).

Në atë rast, prodhimi i jogurtit në Kosovë do të ketë akoma përfitime nga origjina preferenciale në marrëveshjen dypalëshe me Shqipërinë.

Zgjidhja e parë do të jetë **kumulimi dypalësh në rast se qumështi tërësisht i përfituar është importuar nga Shqipëria për prodhimin e jogurtit në Kosovë**. Siç mund të shihet nga shembulli i mësipërm, kërkesa për të përdorur qumështin tërësisht të përfituar në prodhimin e jogurtit është e domosdoshme për fituar origjinën preferenciale për jogurt. Prandaj, qumështi i prodhuar dhe tërësisht i përfituar në Shqipëri, mund të eksportohet edhe në Kosovë për prodhimin e jogurtit në Kosovë, nëse Kosova nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për prodhimin e qumështit. Edhe me këto kushte, jogurti i prodhuar në Kosovë do të ketë origjinë preferenciale në marrëveshjen dypalëshe me Shqipërinë falë kumulimit dypalësh, sepse materialet me origjinë nga një Palë tjetër Kontraktuese do të konsiderohen që kanë origjinë nga Pala Kontraktuese eksportuese.



8 KUMULIMI DIAGONAL:

Nëse supozojmë se prodhuesi i njëjtë i jogurtit në Kosovë ka gjetur një shkallë të mirë të kërkesës në Maqedoni dhe Bosnje dhe Hercegovinë, jogurti i njëjtë i prodhuar në Kosovë për përpunim të qumështit, i cili tërësisht është përfituar nga Shqipëria, do të ketë origjinë preferenciale në tregtinë dypalëshe me Maqedoninë dhe Bosnje dhe Hercegovinën. Kjo është akoma e mundur në kushtet e mëposhtme nëse kumulimi diagonal mundësohet me:

- Marrëveshjen Dypalëshe apo Rajonale të Tregtisë së Lirë (siç është CEFTA) dhe
- rregullat identike të origjinës që do të zbatohen në marrëveshjet përkatëse të tregtisë së lirë (CEFTA).

Mirëpo, nëse njëra nga Palët e CEFTA-s ka ndryshuar/plotësuar legjislacionin e saj dhe ka ngritur standardet e saj veterinarë në nivel të BE-s, në atë rast, eksportuesi i jogurtit i Kosovës mund të hasë në masë jo-tarifore e cila mund të ndalojë përdorimin e qumështit tërësisht të përfituar në Shqipëri në eksportin e jogurtit tek ajo Palë e caktuar e CEFTA-s, e cila i ka përshtatur standardet e saj SFS me ato të BE-s. Më pas, zgjidhja e mundshme do të ishte importimi i qumështit tërësisht të përfituar në njërin nga shtetet anëtare të BE-s, që plotëson të gjitha standardet SFS për qumësht dhe të prodhojë jogurt në Kosovë për sa kohë respektohen të gjitha standardet tjera teknike dhe veterinarë për produkte specifike të Palës importuese të CEFTA-s.



Rasti i lartëpërmendur është i mundshëm falë protokollit të origjinës të CEFTA-s, që lejon kumulimin e materialeve me origjinë nga BE-ja, EFTA dhe Turqia në marrëveshjen tregtare rajonale midis Palëve të CEFTA-s.

Nëse, i njëjti produkt (jogurti i prodhuar në Kosovë) me qumështin tërësisht të fituar nga BE eksportohet në BE, EFTA apo Turqi, produkti i njëjtë do të mund të marrë origjinën preferenciale pasi të plotësojë kushtet në vijim:

- Marrëveshja Dypalëshe apo Rajonale për Tregti të Lirë (CEFTA dhe MSA-t e BE-s dhe MTL-t dypalëshe me EFTA-n dhe Turqinë)
- Rregullat identike të origjinës që do të zbatohen në marrëveshjet përkatëse të tregtisë së lirë (në CEFTA, MSA-t me BE-n, MTL-t dypalëshe me EFTA-n dhe Turqinë, marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë ndërmjet BE-s dhe EFTA-s, dhe BE-s dhe Turqisë – Sindikatat Doganore BE/TK)
- Nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës PEM dhe fillimi i zbatimit të kumulimit diagonal të shpallur në njoftimin e Komisionit

Pasi që Turqia dhe EFTA nuk i kanë liberalizuar plotësisht produktet bujqësore ndërmjet tyre dhe BE-s, eksporti i jogurtit të përpunuar në Kosovë në EFTA dhe Turqi nuk do të mund të përfitojë nga liberalizimi i plotë, por nga **norma preferenciale e doganës me kusht që Kosova të nënshkruajë marrëveshjet e tregtisë së lirë me EFTA-n dhe Turqinë, si dhe Kosova do të duhet të nënshkruajë dhe ratifikojë Konventën PEM**

Nëse jogurti i prodhuar në Kosovë nga qumështi tërësisht i përfituar nga BE-ja, përmbush standardet SFS të BE-s dhe standardet SFS të EFTA-s për jogurt që do të eksportohet në EFTA, **përsëri Kosova do të duhet të nënshkruajë dhe ratifikojë MTL-n me EFTA-n, si dhe Konventën PEM për të përfituar nga origjina preferenciale për eksportin e saj të eksportuar në EFTA sipas kumulimit diagonal**



SHËNIM I RËNDËSISHËM: Mbështetja e kumulimit të lartpërmendur diagonal me BE-n dhe Partnerët tjerë të MTL-ve të Palëve të CEFTA-s është e mundshme vetëm me nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventës PEM. Tani për tani, të gjitha marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë në mes veti rregulla identike të origjinës. Prandaj, kumulimi diagonal mund të ndodhë midis rrjetit të këtyre blloqeve të MTL-ve (CEFTA, MSA-t e BE dhe MTL-t dypalëshe me EFTA-n dhe Turqinë) i cili quhet SAP + kumulimi. Përveç kësaj, të gjitha këto marrëveshje të lartpërmendura të tregtisë së lirë kanë vendosur lidhjet me Konventën PEM.

Kjo nënkupton se kur të rishikohet Konventa PEM dhe të rishikohen rregullat siç përshkruhet në këtë udhëzues, të gjitha MTL-t e lidhura me Konventën PEM do të kenë automatikisht rregulla të reja të origjinës. Mirëpo, në rastin e Kosovës, pasi që ajo nuk ka nënshkruar apo ratifikuar Konventën PEM, çdo kumulim diagonal i vendosur sipas gjendjes së tanishme do të ndërpritet në tregtinë rajonale brenda CEFTA-s ose me Partnerët e tjerë të MTL-ve. Konventa PEM është kusht i domosdoshëm për të drejtuar SAP + kumulimin apo kumulimin diagonal me çdo Palë tjetër Kontraktuese të Konventës PEM.

Për sqarim të më tutjeshëm të kumulimit diagonal është dhënë shembulli nga industria e makinave për të dhënë rregull më të ndërlukuar specifik për produkte. Rregulli i caktuar për produkte gjendet në Kapitullin 87. Prandaj, për të përcaktuar origjinën preferenciale të një makine të prodhuar në njërin nga Palët Kontraktuese të Konventës PEM duhet të zbatohen dy rregullat në vijim.

Kreu SH	Përshkrimi i produktit	Punimi apo përpunimi, i kryer me material pa origjinë, të cilat japin statusin e origjinës
Ish Kapitulli 87	Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonet e hekurudhës ose tramvajit, pjesët dhe plotësuesit e tyre; përveç për:	Prodhimi ku vlera e të gjitha materialeve nuk tejkalon 45% të çmimit franko të produktit
8708	Pjesët dhe plotësuesit për mjete të transportit të kërëve 8701 deri 8705	Prodhimi prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, Apo Prodhimi ku vlera e të gjitha materialeve nuk tejkalon 50% të çmimit franko të produktit


Kodi SH për automjetet të ri për udhëtarë me motor 1.6 L është 8703.23. Për këtë arsye duhet të zbatohet rregulli i lartpërmendur për Kapitullin 87. Mirëpo, siç thotë rregulli i njëjtë për pjesë dhe plotësues për mjete transportuese të klasifikuara nën 8703 do të duhet të respektohet qoftë

- Prodhimi prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit,

OSE

- Prodhimi ku vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk tejkalon 50% të çmimit franko të produktit.

Nëse e krijojmë rastin hipotetik në vijim për zinxhirin e furnizimit të automjeteve midis BE-s, Serbisë, EFTA-s, Turqisë dhe vendeve të treta; mund të supozojmë se duhet të respektohen kushtet në vijim për kumulim diagonal për të përfituar nga origjina preferenciale.



Sipas skenarit të mësipërm, mund të supozojmë rezultatet në vijim:

- Automjetet e prodhuara në Serbi me pjesë të importuara nga BE-ja, Turqia, Maqedonia dhe vendet tjera plotësojnë rregullin e kërkuar specifik për produkte të çmimit franko prej 45%, edhe pse vlera e shtuar e Serbisë në automjetet e prodhuara në Serbi është vetëm 10%, dhe vlera kumulative e shtuar në Serbi dhe të gjithë partnerëve të saj të kumulimit diagonal arrin 75% të çmimit franko të prodhimit final.
- Rregulli që zbatohet për pjesët që do të montohen në automjetet që do të prodhohen në Serbi është 50% i çmimit franko të produktit. Prandaj, të gjitha pjesët e prodhuara në BE, Turqi dhe Maqedoni përmbushin pragun e kërkuar.
- Vlerat e materialeve pa origjinë në pjesët e importuara nga BE-ja, Turqia dhe Maqedonia nuk do të merren parasysh gjatë prodhimit të automjeteve në Serbi me kusht që pjesët e prodhuara në BE, Turqi dhe Maqedoni të japin origjinën preferenciale duke respektuar rregullin për specifika përkatëse të produktit (Neni 4 paragrafi 2 i Shtojcës I)³.
- Serbia do të ketë ende mundësi të rris vëllimin e materialeve pa origjinë deri në 45% të çmimit franko të produktit final dhe mund ta përshtat importimin nga partnerët e saj të kumulimit diagonal për ta bërë konkurrues çmimin e produktit

³ Neni 4.2. Nëse produkti që ka fituar statusin e origjinës në një Palë Kontraktuese në pajtim me paragrafin I (gjegj. duke respektuar kushtet e përcaktuara në rregullat për specifikat e produktit) përdoret si material në prodhimin e një produkti tjetër, nuk do të merren parasysh materialet me origjinë, të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

të eksportuar, por duke përmbushur njëkohësisht kriteret e nevojshme për origjinë preferenciale.

- Automjetet e prodhuara në Serbi do të kenë origjinë preferenciale në eksportet nga Serbia në BE, Turqi dhe CEFTA në kontekstin e SAP+ kumulimit dhe Konventës PEM, sepse Serbia ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM dhe ka MTL-t me BE-n, EFTA-n dhe Turqinë që kanë rregulla identike të origjinës me Konventën PEM.

9 KUMULIMI I PLOTË DYPALËSH DHE DIAGONAL:

Si risi, versioni i rishikuar i Konventës PEM do të paraqesë mundësinë e kumulimit të plotë dypalësh ndërmjet Palëve Kontraktuese për të gjitha produktet e mbuluara me Konventë, përveç produkteve që bëjnë pjesë në Kapitujt 50 deri 63.

Kjo nënkupton se **punimi dhe përpunimi** i kryer tek Pala Kontraktuese, përveç Palës Kontraktuese eksportuese, konsiderohet se është kryer tek Pala Kontraktuese eksportuese kur produktet e përfituara i nënshtrohen punimit apo përpunimit pasues tek kjo Palë Kontraktuese eksportuese.

Të marrim shembullin e njëjtë të jogurtit të prodhuar në Mal të Zi e jo në Kosovë, pasi Mali i Zi e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM. Nëse i referohemi fazave të përpunimit të prodhimit të jogurtit, rregulli i ri për kumulimin e plotë dypalësh do të mundësojë njohjen e punimit dhe përpunimit të kryer tek një Palë tjetër e CEFTA-s e cila e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM, që është kryer në Mal të Zi dhe do të mundësonte punimin apo përpunimin shtesë në Mal të Zi, së bashku me punimin dhe përpunimin tek një Palë tjetër e CEFTA-s.

Fazat e përpunimit të prodhimit të jogurtit:

- Përshtatja e përbërjes së qumështit për të arritur përmbajtjen e dëshiruar të yndyrës dhe lëndëve të ngurta dhe përbërësit e përzierjes (siç janë stabilizuesit)
- Pasterizimi i qumështit/ Trajtimi i lartë
- Homogjenizimi për të përzierë të gjithë përbërësit
- Ftohja e qumështit
- Inokulimi me kulturat fillestare (siç janë *Lactobacillus bulgaricus* dhe *Streptococcus thermophilus*)
- Mbajtja për të arritur nivelin e dëshiruar të pH-s për të mundësuar fermentimin
- Ftohja për të ndërprerë procesin e fermentimit
- Shtimi i frutave dhe shijes
- Ambalazhimi

Të supozojmë se përveç dy përpunimeve të fundit (gjegj. shtimi i frutave dhe shijeve dhe ambalazhimi) kryhen tek njëra nga Palët e CEFTA-s, siç është Shqipëria dhe qumështi i fermentuar është eksportuar në Malin e Zi e pastaj frutat dhe shijet janë shtuar dhe ambalazhuar në Malin e Zi. Nëse, produkti final, jogurti i paketuar me shije frutash, eksportohet nga Mali i Zi në Shqipëri, produkti do të marrë origjinën malazeze me trajtim preferencial në Shqipëri. E tërë puna dhe përpunimi i kryer tek një Palë tjetër e CEFTA-s do të konsiderohet që është kryer në Malin e Zi.

Trajtimi i njëjtë preferencial do të pranohet kur produkti i njëjtë eksportohet tek një Palë tjetër e CEFTA-s, pasi CEFTA ka miratuar Vendimin Ministror i cili paraqet kumulimin diagonal në tregtinë rajonale (Vendimi i CEFTA-s 3/2015, http://cefta.int/wp-content/uploads/2016/05/Decision-No_3_2015_Amending-Decison-No-3-2013-1.pdf).

Dispozita e njëjtë do të përfshihet edhe në listën e shmangieve të Konventës së rishikuar PEM sipas Aneksit II të Shtojcës II).

Përveç kësaj, Konventa e rishikuar PEM parashikon kumulimin e plotë diagonal si parim të përgjithshëm përveç për produktet e klasifikuara ndërmjet Kapitujve 50 dhe 63. Prandaj, kumulimi i plotë diagonal nuk zbatohet vetëm në tregtinë dypalëshe ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë, por edhe me Palët tjera të CEFTA-s, kur jogurti përpunohet në Mal të Zi dhe Shqipëri. Produkti do të fitojë origjinën malazeze si pjesë e kumulimit të plotë diagonal.

Kumulimi i plotë diagonal do të jetë gjithashtu i zbatueshëm kur produkti i njëjtë që përfiton nga punimi dhe përpunimi i përbashkët në Mal të Zi dhe Shqipëri eksportohet në BE, EFTA apo Turqi, me kusht që ai jogurt të prodhohet nga qumështi tërësisht i përfituar dhe të respektojë standardet tjera teknike dhe veterinarë.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Nuk do të ketë dallime qenësore ndërmjet kumulimit diagonal dhe kumulimit të plotë dypalësh kur bëhet fjalë për trajtimin preferencial për produkte, përveç atyre në Kapitujt 50 deri 63. Mirëpo, do të promovohet integrimi ekonomik, sepse punimi dhe përpunimi nga të dy Palët Kontraktuese (apo më shumë se dy vendeve në rastin e CEFTA-s) do të konsiderohen si një, e jo origjina e materialeve që do të përfshihen. Në rastin e CEFTA-s, liberalizimi i tregtisë së shërbimeve do të jetë gjithashtu një element shtesë për promovimin e integritit ekonomik dhe investimeve. Përveç kësaj, liberalizimi i fuqisë së kualifikuar punëtore dhe masave për lehtësim të tregtisë dhe transportit që do të zbatohen në Regjionin e Ballkanit Perëndimor, do të jenë masa plotësuese për kumulim të plotë dypalësh siç parashikohet në Konventën PEM.

10 KUMULIMI I PLOTË DYPALËSH PËR KAPITUJT 50 DERI 63:

Dallimet në trajtimin preferencial ndërmjet kumulimit dypalësh apo diagonal dhe kumulimit të plotë (dypalësh) mund të shfaqen në masë të madhe në prodhimin e tekstilit dhe veshjeve.

Për shkak të qartësisë dhe thjeshtimit, do të merren parasysh vetëm katër faza të procesit të prodhimit.

Ekzistojnë katër procese të mëposhtme si faza kryesore të prodhimit të tekstilit dhe veshjeve:

- Prodhimi i fibrave
- Prodhimi i fillit
- Prodhimi i pëlhurës
- Përfundimi

Me qëllim që lexuesi ta kuptojë konceptin e kumulimit të plotë të këtij udhëzuesi, ceken në hollësi rregullat e Konventës ekzistuese PEM për produkte specifike.

		Konventa Ekzistuese PEM	Konventa e Rishikuar PEM
Kreu SH	Përshkrimi i produktit	Punimi apo përpunimi, i kryer për materialet pa origjinë, me çka fitohet statusi i origjinës	
Ish 6202, ex 6204, ish 6206, ish 6209, dhe ish 6211	Veshje për gra, vajza dhe bebe dhe plotësues të veshjeve të bebeve, të qendisura	Prodhimi nga filli ⁽⁹⁾ apo Prodhimi nga pëlhura e paqëndisur, me kusht që vlera e pëlhurës së paqëndisur të mos tejkalojë 40 % të çmimit franko të produktit ⁽⁹⁾ ⁽⁹⁾ Shih Shënimet Hyrëse 6.	Endja e kombinuar me punimin, përfshirë prerjen e pëlhurës apo Prodhimi nga pëlhura e paqëndisur, me kusht që vlera e pëlhurës së paqëndisur të mos tejkalojë 40 % të çmimit franko të produktit ⁽³⁶⁾ ⁽³⁶⁾ Shih Shënimet Hyrëse 7.
Shënimet hyrëse 6 të Konventës ekzistuese PEM:	Shënim 6: 6.1. Kur referenca bëhet në këtë Shënim, në listë, materialet e tekstilit (me përjashtim të astareve dhe nën-astareve), të cilat nuk plotësojnë rregullin e përcaktuar në listën e shtyllës 3 për produktet e bëra përkatëse, mund të përdoren, me kusht që ato klasifikohen në një krye tjetër përveç atij të produktit dhe vlera e tyre nuk tejkalon 8 % të çmimit franko të produktit. 6.2. Pa cenuar Shënimin 6.3, materialet që nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri 63, mund të përdoren lirisht në prodhimin e produkteve të tekstilit, pavarësisht nëse përmbajnë apo jo tekstile.		

	Shembulli: Nëse një rregull në listë parashikon, për një artikull të veçantë tekstili (si pantollonat), se duhet përdorur fille, kjo nuk e ndalon përdorimin e artikujve të metalit, siç janë butonat, sepse butonat nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri 63. Për arsyen e njëjtë, ai nuk ndalon përdorimin e mbërthyesve të rrëshqitshëm, edhe pse mbërthyesit e rrëshqitshëm zakonisht përmbajnë tekstil. 6.3. Aty ku zbatohet rregulli i përqindjes, gjatë llogaritjes së vlerës së materialeve të përfshira pa origjinë duhet të merret parasysh vlera e materialeve pa origjinë që nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri 63.
Shënimi Hyrës 7 i Konventës së rishikuar PEM	Shënimi 7 – Tolerancat tjera të zbatueshme për produkte të caktuara të tekstilit 7.1. Kur referenca bëhet në këtë Shënim në listë, materialet e tekstilit (me përjashtim të astareve dhe nën-astareve), të cilat nuk plotësojnë rregullin e përcaktuar në listën e shtyllës 3 për produktet e bëra përkatëse, mund të përdoren, me kusht që ato klasifikohen në një krye tjetër përveç atij të produktit dhe vlera e tyre nuk tejkalon 15 % të çmimit franko të produktit. 7.2. Pa cenuar Shënimin 6.3, materialet, që nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri 63, mund të përdoren lirisht në prodhimin e produkteve të tekstilit, pavarësisht nëse përmbajnë apo jo tekstile. 7.3. Aty ku zbatohet rregulli i përqindjes, gjatë llogaritjes së vlerës së materialeve të përfshira pa origjinë duhet të merret parasysh vlera e materialeve pa origjinë që nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri 63.

E marrim prodhimin e një produkti veshjesh për të shpjeguar kumulimin e plotë dypalësh. Si shembull është marrë veshja e grave me Kreun 6202.

Rregulli specifik për veshjet e grave ofron dy rregulla alternative.

Edhe pse në rregullin e parë të Konventës së rishikuar përdoret një gjuhë tjetër se ajo në Konventën PEM ekzistuese, rregulli i parë alternativ parashikon një fazë të ngjashme për të fituar origjinën preferenciale për veshje të grave;

- thurja nga filli i kombinuar me punimin, përfshirë prerjen e pëlhurës.

Rregulli i dytë alternativ për të fituar origjinën preferenciale për veshje të grave është

- prodhimi nga pëlhura e paqëndisur me kusht që vlera e pëlhurës së paqëndisur nuk tejkalon 40% të çmimit franko të produktit

Për të shpjeguar kumulimin e plotë dypalësh në veshjen e grave, do të merret parasysh rregulli i parë alternativ.

Të supozojmë se filli i leshit (kreu 5107) për thurje për prodhimin e pëlhurës së leshit importohet nga Egjipti në Turqi. Filli sintetik i fibrave shtapël (kreu 5509) me origjinë nga India do të importohet gjithashtu në Turqi për thurje për të prodhuar pëlhurë leshi të kreut 5112. Si Egjipti, ashtu edhe Turqia nuk janë nënshkruese të CEFTA-s, edhe pse Turqia ka MTL-t me të gjitha Palët e CEFTA-s, përveç Kosovës. Por ato janë palë kontraktuese të Konventës PEM. India nuk është palë kontraktuese e Konventës.



Rregulli i caktuar i produkteve të fillit të leshit kërkon tjerren e fibrave natyrale. Të supozojmë se kjo kërkesë është përmbushur në Egjipt dhe filli i leshit ka origjinë preferenciale kur eksportohet në Turqi për përzierje me fillin sintetik që do të importohet nga India.

Rregulli për specifika të produkteve për prodhimin e pëlhurës së leshit kërkon prodhimin e pëlhurës për të përdorur fibra natyrale dhe/apo artificiale. Prandaj, pëlhura që do të prodhohet në Turqi nuk do të përmbushte kriteret e nevojshme, nëse eksportohet në Maqedoni sepse rregulli kërkon prodhimin nga fibrat, ndërsa prodhimi në Turqi përdor fillin e importuar nga Egjipti dhe India.

Në rast të prodhimit në Maqedoni, pëlhura e përdorur në veshjet për gra duhet të bazohet në thurjen e fillit për të prodhuar pëlhurën, si dhe prerjen e asaj pëlhure. Ndryshe, prodhimi në Maqedoni mund të përdorë pëlhurën e paqëndisur pa origjinë deri në 40% të çmimit franko të produktit.

Nëse vazhdojmë me shembullin në vijim të prodhimit të pëlhurës së leshit në Turqi, pëlhura e leshit nuk do të ketë origjinë preferenciale, por prap mund të përdoret në prodhimin e veshjeve për gra deri në 40% të çmimit franko të produktit final. Në këtë rast, nuk zbatohen as kumulimi dypalësh, as diagonal e as kumulimi i plotë dypalësh.

Mirëpo, në rast se prodhimi i veshjeve për gra bëhet në Egjipt me përdorimin e pëlhurës së leshit të prodhuar në Turqi, që përmban fill leshi nga Egjipti dhe fill sintetik të importuar nga India (deri në 15% të çmimit franko të pëlhurës së përzier duke përdorur fillin e leshit sipas Shënimit Fillestar 6 të Konventës së Rishikuar PEM), veshja e përfunduar për gra do të ketë origjinë preferenciale kur eksportohet në Turqi.

Pasi kumulimi i plotë dypalësh zbatohet për produktet e mbuluara nga Kapitujt 50 deri 63 në tregtinë dypalëshe ndërmjet dy partnerëve të MTL-s, origjina preferenciale mund t'i jepet veshjes së përfunduar. Kjo është ndryshe nga kumulimi dypalësh apo diagonal sipas rregullave të tanishme të Konventës PEM.

Kumulimi diagonal merr parasysh origjinën e materialit të eksportuar. Në rastin e shembullit të mësipërm, prodhimi i pëlhurës në Turqi nuk plotëson kriteret e origjinës preferenciale kur zbatohen rregullat e kumulimit dypalësh apo diagonal. Pëlhura duhet të prodhohet nga fibrat dhe kjo nuk ndodh në shembullin e mësipërm.

Mirëpo, kumulimi i plotë merr parasysh fazat e punimit dhe përpunimit e jo origjinën e materialeve. Prandaj, punimi dhe përpunimi i kryer tek Pala Kontraktuese importuese konsiderohet se është kryer tek Pala Kontraktuese eksportuese kur produktet i nënshtrohen punimit dhe përpunimit pasues tek kjo Palë Kontraktuese eksportuese. Ky rregull zbatohet në tregtinë dypalëshe, nëse kumulimi i plotë do të përfshijë produktet e tekstilit dhe veshjeve (Kapitujt 50 deri 63).



Sipas shembullit të mësipërm, nuk zbatohet kumulimi i plotë dypalësh në tekstil dhe veshje nëse përfundimi kryhet tek njëra nga Palët e CEFTA-s, e cila ka nënshkruar MTL-n me Turqinë. Arsyeja për të mos pasur origjinë preferenciale nëse përfundimi është bërë në CEFTA dhe është eksportuar në Turqi është se kumulimi i plotë për tekstil dhe veshje është i zbatueshëm vetëm në tregtinë dypalëshe si rregull i përgjithshëm.

Nga ana tjetër, të supozojmë kapacitetin e prodhimit të pëlhurës në njërin nga Palët e CEFTA-s, e cila ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM (p.sh. Maqedonia). Kështu, filli i leshit importohet sërish nga Egjipti dhe filli sintetik nga India. Që të dy vendet do të trajtohen si vende pa origjinë pasi që Maqedonia nuk ka MTL me Egjiptin dhe India nuk është Palë Kontraktuese e Konventës PEM.



Prodhimi i pëlhurës së leshit kërkon përdorimin e fibrave, e jo të fillit. Përveç kësaj, nuk ka MTL ndërmjet Maqedonisë dhe Egjiptit. Operacioni i përfundimit të veshjeve për gra në Turqi me përdorimin e pëlhurës së prodhuar në Maqedoni nuk do të ketë origjinë preferenciale nëse vlera e pëlhurës nuk është më e ulët se 40% e çmimit franko të produktit final. Veshjet e përfunduara për gra nuk mund të eksportohen në Shqipëri me origjinë preferenciale edhe pse Maqedonia, Turqia dhe Shqipëria kanë Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë dhe rregulla identike të originës dhe janë Palë Kontraktuese të Konventës PEM. Arsyeja është se kumulimi diagonal ndërmjet Maqedonisë, Shqipërisë dhe Turqisë nuk ofron fleksibilitet të mjaftueshëm për produkte të caktuara të veshjeve për të marrë origjinën preferenciale dhe kumulimi i plotë zbatohet vetëm në tregtinë dypalëshe, por jo në tregtinë diagonale/rajonale.

Mirëpo, nëse supozojmë se filli prodhohet tek njëra nga Palët e CEFTA-s, e cila ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM dhe ka eksportuar tek një Palë tjetër e CEFTA-s për prodhimin e pëlhurës së leshit, e cila është gjithashtu palë kontraktuese e Konventës PEM, atëherë, përfundimi do të bëhet tek një Palë tjetër e CEFTA-s, dhe ka eksportuar tek një nga SAP + Partnerët e Palëve të CEFTA-s, që kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën PEM dhe kanë MTL dypalëshe me Partner përkatës SAP.

Prandaj, paraqitja e sipërme do të duket si ajo në vijim:



- Rregullat e Konventës së rishikuar PEM vendos me qëllim të zbatimit të kumulimit të plotë dypalësh që Palët e CEFTA-s do të konsiderohen si një Palë Kontraktuese.
- Kështu, veshjet e përfunduara për gra në Maqedoni do të plotësojnë dy faza të transformimit. Prodhimi i fillit në Serbi, pëlurës së leshit në Shqipëri dhe përfundimi i pëlurës në Maqedoni do të konsiderohet se janë ndërmarrë tek një Palë Kontraktuese nga BE-ja apo EFTA apo Turqia gjatë importimit të veshjeve të grave nga BE/EFTA/Turqia nga Maqedonia. Tregtia dypalëshe ndërmjet BE/EFTA/Turqisë dhe Maqedonisë do të shqyrton proceset e mëhershme të prodhimit të tekstilit dhe veshjeve, të cilat mund të ndodhin në dy palët tjera të CEFTA-s si një dhe mund të zbatohet kumulimi i plotë dypalësh.


11 KUMULIMI I PLOTË DIAGONAL PËR KAPITUJT 50 DERI 63:

Konventa e rishikuar PEM përcakton se ende mund të zbatohet kumulimi i plotë diagonal për produktet e tekstilit dhe veshjeve, në rast se Palët Kontraktuese mund të preferojnë të shtyjnë njëanshëm zbatimin e kumulimit të plotë dypalësh në importimin e Kapitujve 50 deri 63. Komiteti i Përbashkët i Konventës do të duhet të njoftohet për vendimin mbi vazhdimin e kumulimit të plotë në tregtinë diagonale, si dhe mbi të gjitha modifikimet e tij.

Në rastin e CEFTA-s, CEFTA tashmë ka pranuar një shmangie në bazë të vendimit të saj 3/2015 lidhur me zbatimin e kumulimit të plotë diagonal në tregtinë rajonale të CEFTA-s për të gjitha produktet, përfshirë tekstin dhe veshjet. Prandaj, kumulimi i plotë diagonal ndërmjet Palëve të CEFTA-s, së bashku me dispozitën që llogarit Palët e CEFTA-s si një Palë Kontraktuese për kumulim të plotë dypalësh në Konventën e rishikuar do të lehtësojë zbatimin e kumulimit të plotë diagonal në tregtinë rajonale.



Para se ta përmbyllim këtë pjesë, duhet të merret parasysh paraqitja e mëposhtme për të përmbledhur informatat e dhëna mbi kumulimin e plotë. Shtrirja më e gjerë e Konventës së rishikuar PEM parashikohet për kumulim të plotë për të gjithë sektorët përveç për Kapitujt 50 deri 63, ndërsa për kufizime zbatohet kumulimi i plotë në tekstil dhe veshje sepse, sipas rregullit, ai zbatohet vetëm në tregtinë dypalëshe.



12 RREGULLA TJERA PËR T'I RESPEKTUAR:

Ekzistojnë disa rregulla tjera të parashikuara me Konventën PEM të cilat duhet respektuar kurdo që kushtet e përshkruara të paraqiten si në vijim.

12.1 PARIMI I TERRITORIALITETIT:

Ngjashëm me Konventën ekzistuese PEM, Konventa e rishikuar kërkon gjithashtu që të fitohet origjina preferenciale sipas Konventës për t'u përmbushur pa ndonjë ndërprerje në Palën përkatëse Kontraktuese. Kjo nënkupton se produktet në procesin e prodhimit nuk pritët që të largohen nga zona e kumulimit.

Në rast se një dërgesë ka dalë jashtë zonës së kumulimit, produktet me origjinë që eksportohen jashtë zonës konsiderohen pa origjinë, përveç kur demonstron, sipas bindjes së autoriteteve doganore, kushtet e mëposhtme.

- Produktet e kthyer janë të njëjtat si ato që u eksportuan
- Ato nuk kanë pësuar asnjë operacion përtej asaj që është e nevojshme për t'i mbajtur ato më pas në kushte të mira kur ato të jenë jashtë zonës së kumulimit apo gjatë eksportimit

Konventa e rishikuar mundëson përpunimin e jashtëm me kusht që vlera e shtuar totale e marrë jashtë Palës Kontraktuese eksportuese nuk pretendohet të tejkalon 10% të çmimit franko të produktit final, për të cilin është kërkuar origjina preferenciale.

12.2 MOS-NDRYSHIMI:

Ngjashëm me Konventën ekzistuese PEM, Konventa e rishikuar ndalon që produktet të cilat plotësojnë kërkesat për origjinë preferenciale të ndryshohen, transformohen në ndonjë mënyrë apo të jenë subjekt i operacioneve, të cilat nuk janë cekur në vijim. Lejohen operacionet e mëposhtme dhe mund të konsiderohen si operacione mos-ndryshuese me origjinë preferenciale.

- të ruhen në gjendje të mirë
- t'u shtohen apo vendosen shenjat, etiketat, vulat apo ndonjë dokumentacion për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat vendore të Palës Kontraktuese importuese, që kryhen nën mbikëqyrje doganore në vendet e tranzitit (siç janë ngjitja e pullave shirit në shishe e pijeve alkoolike për qëllime të akcizës)
- Ndarja e drëgesës para se të deklarohet për përdorim shtëpiak
- Ruajtja e produkteve apo dërgesës me kusht që ato të mbeten nën mbikëqyrje doganore në vendet e treta të tranzitit
- Ndarja e dërgesës mund të bëhet me kusht që ato të mbeten nën mbikëqyrje doganore në vendet e treta të ndarjes

Mund të kërkohet nga importuesi apo përfaqësuesi i tij të ofrojë në çdo kohë prova të pajtueshmërisë. Dokumentet në vijim janë cekur si prova të rëndësishme në mes tjerash:

- Dokumentet kontraktuale të transportit siç është fatura e ngarkimit,
- Provat faktike apo konkrete në bazë të shënimit apo caktimit të numrit të paketave,
- Çdo provë që ka të bëjë me vet mallrat,
- Certifikata nëse mos-manipulimi i parashikuar nga autoritetet doganore të vendeve të tranzitit apo ndarjes apo çdo dokument tjetër tregon se mallrat kanë mbetur nën mbikëqyrje doganore në vendet e tranzitit apo ndarjes

12.3 RREGULLI I PËRGJITHSHËM I TOLERANCËS:

Konventa e Rishikuar PEM ofron një rregull të përgjithshëm të tolerancës se ajoe 10% të çmimit franko të parashikuar në Konventën ekzistuese PEM. Rregulli i përgjithshëm i tolerancës lejon përdorimin e materialeve pa origjinë deri në një prag të caktuar edhe nëse rregullat për specifika të produktit nuk mund të plotësohen. Sipas Konventës së Rishikuar PEM, rregulli i ri i përgjithshëm i tolerancës është ose 15% e peshës neto të produkteve që bëjnë pjesë në Kapitujt 2 dhe 4 deri 24 se sa produktet e përpunuara të peshkut (peshkimit) të Kapitullit 16 apo 15% të çmimit franko të produktit për produktet tjera se ato të lartpërmendura.

Rregulli i përgjithshëm i tolerancës nuk lejon që të tejkalohen pragjet e përmendura në rregullat për specifika të produktit.

Ekzistojnë rregulla të tolerancës më të lartë, të parashikuara për produktet në Kapitujt 50 deri 63. Tolerancat për produktet specifike të tekstilit dhe veshjes mund të gjenden në shënimet shpjeguese për rregullat për specifika të produkteve.

12.4 KTHIMI:

Konventa e rishikuar PEM jep ndryshime të rëndësishme në regjimin e kthimit të tarifës. Konventa ekzistuese PEM ndalon kthimin e tarifës si parim i përgjithshëm edhe pse përjashtimet janë specifikuar në Konventë apo shmangiet janë parashikuar me dispozita të veçanta.

Ndërsa lejohet kthimi i tarifës me Konventën e rishikuar PEM, përveç asaj në tregtinë preferenciale të produkteve që bëjnë pjesë në Kapitujt 50 deri 63.

Ndërsa e kthimit të tarifës në Kapitujt 50 deri 63 mbetet akoma si rregull i përgjithshëm. Mirëpo, kthimi i tarifës mund të lejohet në zbatimin e kumulimit të plotë, qoftë si kumulim i plotë dypalësh apo kumulim i plotë, me kusht që të jetë bërë njoftimi për shmangie nga zbatimi i njëanshëm i kumulimit të plotë diagonal.

Nëse marrim parasysh shembullin e sipërm, filli i leshit i prodhuar tek njëra nga Palët e CEFTA-s, e cila ka nënshkruar dhe kontraktuar Konventën PEM, mund të përdor fibra leshi të importuara nga një vend tjetër, Palë e CEFTA-s që nuk ka një MTL.



Detyrimet duhet të paguhen për fibrën e importuar të leshit nga prodhuesi i fillit në Serbi. Nuk bëhet kthimi i tarifës pasi nuk ka MTL ndërmjet Serbisë dhe Egjiptit dhe nuk zbatohet kthimi i tarifës.

Kur filli i leshit eksportohet nga Shqipëria për prodhimin e pëlhurës, ai do të eksportohet me deklaratën e furnitorit. Filli i leshit i prodhuar në Serbi do të ketë ende statusin pa origjinë në Shqipëri. Mirëpo, ai do të jetë i pranueshëm për kthimin e tarifës, pasi që kthimi i tarifës lejohet nga CEFTA dhe për të është bërë njoftimi në Konventë.

Në rast se prodhuesi shqiptar i pëlhurës përdor gjithashtu fillin sintetik për ta përzier me fill leshi (deri në 15%), detyrimet duhet të paguhen për fillin sintetik të importuar nga India.

Kur pëlhura shqiptare eksportohet në Maqedoni me deklaratën e furnitorit, pëlhura shqiptare do të ketë status jo-preferencial por do të jetë e pranueshme për kthim të tarifës, sepse kthimi i tarifës lejohet nga ana e CEFTA-s dhe njoftimi është bërë në Konventën PEM.

Produkti final i veshjeve për gra, i prodhuar në Maqedoni, do të ketë statusin e origjinës preferenciale kur të eksportohet në BE, EFTA apo Turqi.

13 CERTIFIKATA – PROVË APO ORIGINË

Nëse do t'i referoheshim metodologjisë së shpjeguar në pjesën hyrëse, zbatimi i udhëzuesit mbi Konventën PEM mund të përmbledhet si në vijim:

Rregullat që mundësojnë arritjen e origjinës preferenciale rregullohen me Konventën PEM dhe protokollet e origjinës së marrëveshjeve të tregtisë së lirë ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës PEM.

Pasi të jenë plotësuar ato rregulla, të përcaktuara me Konventën PEM dhe MTL-n përkatëse, ajo duhet të dëshmohet/vërtetohet me vet-deklaratë apo certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore. Emri i përgjithshëm i kësaj certifikate është prova e origjinës.

Ndryshe nga Konventa ekzistuese PEM, Konventa e rishikuar PEM kërkon ose Certifikatën e Qarkullimit EUR 1 apo deklaratën e origjinës. Deklarata e origjinës mund të lëshohet për të gjitha dërgesat, që përbëhen nga një apo më shumë pako, të cilat përmbajnë produkte me origjinë, vlera e të cilave nuk tejkalon EUR 6000 apo nga një eksportues i aprovuar në cilëndo Palë Kontraktuese.

Ndërsa, deklarata e furnitorit apo deklarata afatgjatë e furnitorit nevojitet kur produktet me origjinë prodhohen nga produktet me origjinë jo-preferenciale, të cilat punohen apo përpunohen tek Palët tjera Kontraktuese me të cilat zbatohet kumulimi i plotë.

Në importimin e produkteve, totali i të cilave nuk tejkalon EUR 500 në rastin e pakove të vogla nga personat privat tek personat privat apo për produktet e importuara që përbëjnë pjesë të bagazhit personal të udhëtarit, vlera e të cilit nuk tejkalon EUR 1200, këto produkte mund të pranohen si statuse të origjinës pa kërkuar paraqitjen e provës së origjinës.

Shkurtimisht, tabela vijuese mund të përmbledh llojet e certifikatave të nevojshme.

Lloji i certifikarës	Lloji i kumulimit	Pragu i vlerës	Komentet
EUR 1	Të gjitha llojet e kumulimit	> EUR 6 000	
Deklarat e origjinës	Të gjitha llojet e kumulimit	< EUR 6 000 (nga të gjithë tregtarët) Nuk ka prag për eksportuesit e aprovuar	
Lirohen nga paraqitja e provës së origjinës	n.e.	< EUR 500 (pakot e vogla nga personat privat tek personat privat) Më e ulët se < EUR 1 200 (bagazhi personal i udhëtarit)	
Deklarata e furnitorit	Kumulimi i plotë		Nevojitet për lëshim të deklaratës EUR 1 apo të origjinës në prodhimin final

CERTIFIKATA E QARKULLIMIT EUR 1:

EUR 1 do të bëhet njëra dhe certifikata e vetme që do të parashtrohet në zbatimin e Konventës PEM. Ndërsa, Konventa ekzistuese PEM parashikon edhe certifikatën e qarkullimit EUR-MED dhe deklaratën e origjinës EUR-MED, posaçërisht në tregti me vendet mesdhetare apo ndërmjet vendeve mesdhetare të Konventës PEM. Pas miratimit të Konventës së rishikuar PEM dhe fillimit të zbatimit të saj, EUR 1 do të jetë certifikata e vetme që do të parashtrohet.

RREGULLI: EUR 1 lëshohet nga autoritetet doganore të Palës Kontraktuese eksportuese në kërkesën e bërë me shkrim nga eksportuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Eksportuesi apo përfaqësuesi i tij duhet ta plotësojë, si certifikatën e qarkullimit EUR 1, ashtu edhe formularin e aplikimit, mostrat e të cilave i janë bashkëngjitur këtij udhëzuesi.ⁱ

RREGULLI: Eksportuesi që parashton kërkesën është i përgatitur në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të Palës Kontraktuese eksportuese, të parashtrojë të gjitha dokumentet e duhura që dëshmojnë statusin e origjinës të produkteve përkatëse, si dhe plotësimin e kushteve tjera.

Autoritetet doganore kanë të drejtë të kërkojnë çdo provë dhe të bëjnë inspektimin e llogarive të eksportuesit apo ndonjë kontroll tjetër që konsiderohet i përshtatshëm.

Në veçanti, autoritetet doganore kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrim të produkteve është përfunduar ashtu që të përjashtojë të gjitha mundësitë e shtimeve mashtruese.

Certifikatën e qarkullimit EUR 1 e lëshojnë autoritetet doganore dhe ajo vihet në dispozicion të eksportuesit sapo të jetë kryer apo siguruar eksportimi real.

LËSHIMI I EUR 1 ME EFEKT PRAPAVEPRUES:

EUR 1 mund të lëshohet edhe pas eksportimit të produkteve nëse paraqitet njëra nga situatat në vijim:

- Nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve apo lëshimeve të pavullnetshme apo rrethanave të veçanta
- EUR 1 është lëshuar, por nuk është pranuar në importim për arsye teknike dhe ky incident i është demonstruar, sipas bindjes së autoriteteve doganore
- nuk është ditur në kohën e eksportimit dhe është përcaktuar gjatë transportimit apo ruajtjes së tyre dhe pas ndarjes së mundshme të dërgesave

Autoritetet doganore mund të lëshojnë EUR 1 me efekt prapaveprues brenda dy vjetëve nga data e eksportimit.

LËSHIMI I DUBLIKATIT EUR 1:

Në rast të vjedhjes, humbjes apo shkatërrimit të një certifikate qarkullimi EUR 1, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilët e kanë lëshuar atë, për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

Dublikati e mban datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit EUR 1. Dublikati hyn në fuqi nga ajo datë.

DEKLARATA E ORIGJINËS:

Deklarata e origjinës mund të bëhet nga:

- Një eksportues i aprovuar, statusi i të cilit është dhënë nga autoritetet doganore në përputhje me legjislacionin kombëtar
- Çdo eksportues për çdo ngarkesë, që përbëhet nga një apo më shumë pako të cilat përmbajnë produkte me origjinë, vlera totale e të cilave nuk tejkalon EUR 6 000.

RREGULLI: Nga eksportuesi kërkohet të shkruajë, vulos apo shtyp në faturë, fletëdorëzim apo në ndonjë dokument tjetër tregtar tekstin e deklaratës së origjinës të dhënë në vijim.ⁱⁱ

Nëse teksti i deklaratës së origjinës është shkruar me dorë, ajo duhet të shkruhet me bojë me shkronja të shtypura.

RREGULLI: Deklaratat e origjinës mbajnë nënshkrimin original të eksportuesit në dorëshkrim. Nga eksportuesi i aprovuar nuk kërkohet të nënshkruajë deklaratat e tilla me kusht që ai t'i jep autoriteteve doganore një deklaratë me shkrim ku pranon përgjegjësinë e plotë për çdo deklaratë të origjinës e cila identifikohet sikur ai ta kishte nënshkruar.

RREGULLI: Deklaratën e origjinës mund ta bëjë eksportuesi kur produktet eksportohen apo pas eksportimit (deklarata e origjinës me efekt prapaveprues) me kusht që ajo të paraqitet në vendin importues brenda dy vjetëve pas importimit.

Në rast të ndarjes së dërgesës dhe nëse respektohet afati dy vjeçar, deklaratën e origjinës me efekt prapaveprues e bën eksportuesi i aprovuar i Palës Kontraktuese.

EKSPORTUESIT E APROVUAR:

Autoritetet Doganore të Palës Kontraktuese Eksportuese mund ta autorizojnë eksportuesin tek ajo Palë Kontraktuese që të bëjë deklaratimet e origjinës pavarësisht nga vlera e produkteve të eksportuara përkatëse.

Sipas Kodit Doganor të Bashkimit Evropian, parashtuesit e kërkesës për statusin e eksportuesit të autorizuar duhet të japin informatat në vijim.

Të dhënat mbi parashtuesin e kërkesës:

Kompania:

- Emri i korporatës, EORI, numri identifikues kombëtar, adresa e kompanisë (administrata apo ndërmarrja që zotëron provat e origjinës në varësi të subjektit për të cilin jepet statusi)

Kontakt personi:

- emri, mbiemri, e-mail adresa, numri i telefonit, pozita në kompani.

Veprimtaria tregtare e parashtruesit të kërkesës (tregtar apo prodhues), të dhënat mbi produktet dhe prodhimin:

- Adresa e vendit të prodhimit dhe/apo magazinimit të produkteve
- Produktet që dedikohen për eksport (Kreu SH 4 shifror dhe natyra e produktit)
- Vendi i destinuar /vendet e destinacionit
- Plotësimi i rregullave të origjinës në kuadër të marrëveshjeve të ndryshme preferenciale, shpjegimi i procesit të prodhimit, materialet hyrëse (klasifikimi, vlera, origjina)

Të dhënat mbi eksportet:

Rregullsia e eksporteve në kuadër të trajtimit preferencial **(e panevojshme në tregti sipas marrëveshjeve ku nuk është përfshirë elementi i shpeshtësisë) (në Konventën e rishikuar PEM, nuk kërkohet elementi i shpeshtësisë)**, nëse ka.

Nëse mallrat që do të eksportohen do të distribuohen nga Shtetet tjera Anëtare, ku ceken Shtetet Anëtare përkatëse dhe ku është e përshtatshme autoritetet doganore dhe emri, adresa dhe vendi i biznesit të ndërmarrjes përkatëse.

Të dhënat mbi organizimin e kompanisë:

- Emri i punonjësit përgjegjës për transaksione preferenciale
- Emri i punonjësit përgjegjës për nënshkrimin e deklaratave të origjinës
- Sistemi i kontabilitetit për diferencimin e mallrave me/pa statusin e origjinës preferenciale (gjithashtu rreth sistemit IT në përdorim)
- Trajtimi i dokumenteve preferenciale (prova e origjinës të cilën do ta mbajë parashtruesi i kërkesës)
- Dokumentet që duhet t'i mbajë parashtruesi i kërkesës
- Sistemi i llogarimbajtjes për të garantuar se parashtruesi i kërkesës i posedon të gjitha dokumentet që vërtetojnë origjinën preferenciale
- Përdorimi i procedurës doganore në përpunimin e produktit, në veçanti autorizimi për përpunim të brendshëm, për t'iu shmangur çdo mospajtueshmërie me klauzolën për ndalesën e kthimit të tarifës.

Zotimet e eksportuesit nëse lëshohet autorizimi:

- të paraqes në çdo kohë provën e statusit të origjinës së mallrave të eksportuara
- të mbajë evidencë mbi statusin e origjinës për tre ose katër vjet (varësisht nga periudha e cekur në marrëveshjen preferenciale)
- të bëjë një deklaratë të origjinës vetëm për produktet për të cilat të gjitha provat dhe elementet e kontabilitetit që kërkohet të dëshmojnë origjinën preferenciale mbahen në kohën e eksportit

Të tjera:

- data dhe nënshkrimi i parashtresës së kërkesës
- të ceket nëse aplikimi për autorizim të AE është i pari apo nëse ka të bëjë me vazhdim apo ndryshim;
- autorizimet tjera në përdorim (p.sh. AEO), përfshirë numri i autorizimit
- Informata detyruese mbi origjinën, të dhëna kur kërkohet mundësia të mos nënshkruhen deklaratat e origjinës (heqje dorë nga nënshkrimi). atëherë duhet të jepet një deklaratë me shkrim.

13.1 VLEFSHMËRIA E PROVËS SË ORIGJINËS:

Prova e origjinës (EUR 1 apo deklarata e origjinës) ka **vlefshmëri prej 10 muajsh** nga data e lëshimit apo bërjes në Palën Kontraktuese eksportuese. Ajo duhet të dorëzohet brenda asaj periudhe pranë Autoritetit Doganor të Palës Kontraktuese importuese.

Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme Autoriteti Doganor i Palës Kontraktuese importuese mund të pranojë dëshminë e vonuar të origjinës me qëllim të aplikimit të preferencave tarifore.

Në raste të tjera të paraqitjes së vonuar, Autoriteti Doganor i Palës Kontraktuese importuese mund të pranojë provat e origjinës kur produktet janë paraqitur në doganë para datës së cekur përfundimtare.

13.2 DEKLARATA E FURNITORIT:

Deklarata e furnitorit duhet t'i dorëzohet Autoritetit Doganor të Palës Kontraktuese eksportuese kur produkti final mund të marrë origjinën preferenciale me zbatimin e kumulimit të plotë.

Kur lëshohet certifikata e qarkullimit EUR 1 apo deklarata e origjinës nën kumulim të plotë, duhet të merren parasysh informatat në vijim.

- Informatat mbi mallrat e furnizuara për prodhimin e mallrave me origjinë,
- Kreu tarifar i materialeve të përdorura pa origjinë
- Përshkrimi i materialeve pa origjinë,
- Vlera e materialeve pa origjinë
- Vlera e shtuar totale e fituar tek Palët tjera Kontraktuese ku më herët është bërë punimi dhe përpunimi

Në rast se aplikohet njëri nga shembujt e dhënë për kumulim të plotë, deklaratat e furnitorit duhet të bëhen në tregtinë e mëposhtme dypalëshe.



Deklarata e furnitorit do të shërbejë si provë e punimit dhe përpunimit të bërë tek një Palë Kontraktuese për prodhim të materialeve që do të përfshihen në mallrat, të cilat mund të fitojnë origjinën preferenciale sipas rregullave të Konventës PEM.

Në shembullin e lartpërmendur, filli i leshit që do të prodhohet në Serbi nuk do të ketë origjinë preferenciale kur eksportohet në Shqipëri, sepse filli serb është prodhuar nga fibra që është tjerrur në Egjipt. Prandaj, nuk është respektuar rregulli për specifika të produkteve nga filli i leshit. Mirëpo, eksportet e fillit të leshit nga Serbia në Shqipëri mund të shoqërohen me deklaratën e furnitorit.

Prodhimi i pëlurës në Shqipëri nuk do t'i plotësojë gjithashtu kërkesat e rregullit për specifika të produkteve për pëlurën e leshit, sepse kërkon prodhimin e fibrave. Prandaj, pëlura shqiptare nuk do të përfitojë nga origjina preferenciale kur eksportohet në Maqedoni. Eksportet e pëlurës shqiptare pa origjinë në Maqedoni mund të shoqërohen me deklaratën e furnitorit.

Kur një eksportues maqedonas i veshjeve për gra, që janë përfunduar në Maqedoni, i cili ka përdorur pëlurën e papranueshme shqiptare, të prodhuar nga filli i papranueshëm serb, aplikon tek Autoritetet Doganore për certifikatë të qarkullimit EUR 1 për të eksportuar veshjet për gra në BE, EFTA apo Turqi, duhet të dorëzojë edhe deklaratat e furnitorit për të dëshmuar punimin dhe përpunimin e bërë të Palëve të tjera të CEFTA-s për të përmbushur kërkesat e kumulimit të plotë dypalësh për Kapitujt 50 deri 63.

Janë dy lloje të deklaratës së furnitorit.

I pari duhet të bëhet për çdo dërgesë në formën e dhënë më poshtë nga furnizuesi i çdo dërgese në një fletë letre të bashkëngjitur në faturë, notën e dorëzimit apo çdo dokument tjetër tregtar që përshkruan mallrat në hollësi të mjaftueshme.ⁱⁱⁱ

Lloji i dytë quhet deklarata afatgjatë e furnitorit dhe zbatohet vetëm kur furnitori rregullisht furnizon një konsumator të caktuar me mallra, për të cilat punimi dhe përpunimi i kryer tek një Palë Kontraktuese pritet të mbetet i pandryshueshëm për

një periudhë kohore. Në këto rrethana, ai furnitor mund të jepë një deklaratë të vetme të furnitorit për të mbuluar dërgesat pasuese të atyre mallrave. Deklarata afatgjatë e furnitorit zakonisht mund të jetë e vlefshme për një periudhë deri në **dy vjet** nga data e dhënies së deklaratës.

Autoritetet Doganore mund të caktojnë rregullat që përshkruajnë kushtet në të cilat do të zgjatet afati.

Për deklaratën afatgjatë të furnitorit përdoret formulari i mëposhtëm ^{iv}.

Furnitori duhet të jep deklaratën afatgjatë të furnitorit para ose gjatë dërgesës së tij të parë. Furnitori duhet ta njoftojë menjëherë klientin e tij, nëse deklarata afatgjatë e furnitorit nuk është më e zbatueshme për mallrat e ofruara.

13.3 NDARJA E LLOGARIVE:

Nëse materialet e zëvendësueshme me origjinë dhe pa origjinë përdoren në punimin apo përpunimin e produktit, operatorët ekonomik mund të mbajnë materialet të ndara në llogaritë e tyre pa i ndarë ato fizikisht në stoke të ndara.

Kushti për të zbatuar ndarjen e llogarive është se materialet apo produktet duhet të jenë të zëvendësueshme që nënkupton se ato duhet të jenë të llojit dhe cilësisë së njëjtë, me veçori të njëjta teknike dhe fizike dhe nuk mund të dallohen nga njëri tjetri.

Palët Kontraktuese mund të kërkojnë që zbatimi i ndarjes së llogarive t'i nënshtrohet autorizimit paraprak nga Autoritetet Doganore.

Autoritetet Doganore mund të japin autorizimin për të gjitha kushtet që ata i konsiderojnë të duhura dhe të monitorojnë shfrytëzimin e autorizimit.

Me përdorimin e ndarjes së llogarive duhet të sigurohet se asnjë produkt më nuk mund të konsiderohet me origjinë në Palën Kontraktuese eksportuese se sa të ishte rasti nëse do të ishte përdorur metoda e ndarjes së llogarive.

Nëse aplikohet shembulli i njëjtë i kumulimit të plotë në CEFTA, prodhuesi maqedon i veshjeve për gra mund të ketë të drejtë të përdorë ndarjen e llogarive. Ai mund të ndajë pëlhurat e importuara nga Shqipëria në llogarinë e tij, por jo fizikisht. Mund të sigurojë që një sasi e caktuar e veshjeve për gra mund të prodhohet si me origjinë kur eksportohen në BE, EFTA apo Turqi. Mirëpo, pjesa tjetër e pëlhurës shqiptare do të përdorej për prodhimin e veshjeve për gra që do të eksportohen në një vend tjetër, ku nuk do të zbatohet kumulimi i plotë. Sipas këtij shembulli, produkti i zëvendësueshëm do të jetë pëlhura e importuar nga Shqipëria.

14 SHTOJCAT:

i

Mostrat e certifikatës së qarkullimit EUR.1 dhe aplikimi për certifikatë të qarkullimit EUR.1

Udhëzime printimi

1. Çdo formular duhet të ketë dimensionet 210 x 297 mm; mund të lejohet tolerancë deri minus 5 mm ose plus 8 mm në gjatësi. Letra e përdorur duhet të jetë e bardhë, me madhësi për shkrim, që nuk përmban pulpë mekanike dhe peshon jo më pak se 25 g/m². Ajo duhet të ketë një sfond model me dekorim anësor të shtypur në ngjyrë jeshile, kështu që çdo falsifikim me mjete mekanike apo kimike të shihet me sy.
2. Organet kompetente të palëve kontraktuese mund të rezervojnë të drejtën të shtypin vet formularët apo mund t'i shtypin nga shtypësit e aprovuar. Në rastin e fundit, çdo formularë duhet të përfshijë referencën për aprovimin e tillë. Çdo formularë duhet të mbajë emrin dhe adresën e shtypësit (printer) apo markën me të cilën mund të identifikohet. Ai duhet të mbajë edhe numrin serik, të printuar apo jo, por që të mund të identifikohet.

CERTIFIKATA E QARKULLIMIT

1. Eksportuesi (Emri, adresa e plotë, vendi)	EUR.1 No A 000.000 Para plotësimit të këtij formulari, shih pjesën e pasme.		
3. Pranuesi i mallit (Emri, adresa e plotë, vendi) (Opsional)	2. Certifikata e përdorur në tregtinë preferenciale ndërmjet Dhe (Shkruani vendet, grupet e vendeve apo territoret e duhura)		
	4. Vendi, grupe vendesh apo territori ku produktet konsiderohen me origjinë	5. Vendi, grupe vendesh apo territori i destinacionit	
6. Detajet e transportit (Opsionale)	7. Vërejtjet		
8. Numri i artikullit; Markat dhe numrat; Numri dhe llojet e pakove (¹); Përshkrimi i mallrave	9. Pesha bruto (kg) ose masë tjetër (litra, m³, etj.)	10. Faturat (Opsionale)	

SHËNIME

1. Certifikata nuk duhet të përmbajë fshirje apo fjalë të shkruara sipër njëra tjerës. Çdo ndryshim duhet bërë duke fshirë të dhënat e pasakta dhe duke shtuar çdo korrigjim të nevojshëm. Çdo ndryshim i tillë duhet të inicializohet nga personi që ka plotësuar certifikatën dhe ajo është miratuar nga Autoritetet Doganore të vendit apo territorit që e ka lëshuar.
2. Nuk duhet të ketë hapësirë në mes të artikujve të përfshirë në certifikatë dhe çdo artikull duhet të paraprihet nga numri i artikullit. Nën njësinë e fundit duhet menjëherë të tërhiqet një vijë horizontale. Çdo hapësirë e papërdorur duhet të kalohet me vijë ashtu që shtimet e mëvonshme të bëhen të pamundura.
3. Mallrat duhet të përshkruhen në përputhje me praktikën tregtare dhe të jenë mjaft të detajuara që të mund të identifikohen.

KËRKESA PËR CERTIFIKATË TË QARKULLIMIT

1. Eksportuesi (Emri, adresa e plotë, vendi)	EUR.1 No A 000.000 Para plotësimit të këtij formulari, shih pjesën e pasme.	
3. Pranuesi i mallit (Emri, adresa e plotë, vendi) (Opsionale)	2. Kërkesa për certifikatë që do të përdoret në tregtinë preferenciale ndërmjet dhe ((Plotësoni vendet, grupet e vendeve apo territoret e duhura))	
	4. Vendi, grupe vendesh apo territori ku produktet konsiderohen me origjinë	5. Vendi, grupe vendesh apo territori ku produktet konsiderohen me origjinë
6. Detajet e transportit (Opsionale)	7. Vërejtjet	

8. Numri i njësisë; Markat dhe numrat; Numri dhe llojet e pakove (¹); Përshkrimi i mallrave	9. Pesha bruto (kg) ose masë tjetër (litra, m ³ , etj.)	10. Faturat (Opsionale)

(1) Nëse mallrat nuk janë të ambalazuara, cekeni numrin e njësisë apo cekeni « rifuz » sipas nevojës

DEKLARATA NGA EKSPORTUESI

Unë, i poshtëshënuari, eksportuesi i mallrave të përshkruara në pjesën e pasme,

DEKLAROJ që mallrat përmbushin kushtet e nevojshme për lëshimin e certifikatës së bashkëngjitur;

SPECIFIKOJ në vijim rrethanat të cilat kanë mundësuar që këto mallra të plotësojnë kushtet e lartpërmendura:

.....

.....

.....

.....

PARAQES dokumentet mbështetëse në vijim (i):

.....

.....

.....

.....

MARR PËRSIPËR të paraqes me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse çdo provë mbështetëse të cilat këto autoritete mund të kërkojnë me qëllim të lëshimit të certifikatës së bashkëngjitur, dhe marr përsipër, nëse nevojitet, të dakordohem me çdo inspektim të llogarive të mija dhe për çdo kontroll të prodhimit të mallrave të mësipërme, të kryera nga autoritetet e lartpërmendura;

KËRKOJ lëshimin e certifikatës së bashkëngjitur për këto mallra.

.....

(Vendi dhe data)

.....

(Nënshkrimi)

ii TEKSTI I DEKLARATËS SË ORIGINËS NË GJUHËN ANGLEZE

Versioni anglisht

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizimi doganor nr (1)) deklaron se, përveç nëse është cekur qartë ndryshe, këto produkte janë nga..... (2) Origjinë preferenciale.

..... (3) (Vendi dhe data)

..... (4) (Nënshkrimi i eksportuesit, përveç emrit të personit që nënshkruan deklaratën, duhet të ceket me shkrim të qartë)

(1) Kur të bëhet deklarata e origjinës nga një eksportues i aprovuar, numri i autorizimit të eksportuesit të aprovuar duhet të shkruhet në këtë hapësirë. Kur deklarata e origjinës nuk bëhet nga një eksportues i aprovuar, fjalët në kllapa largohen apo hapësira lihet bosh.

(2) Duhet cekur origjinën e produkteve. Kur deklarata e origjinës ka të bëjë tërësisht apo pjesërisht me produktet me origjinë nga Ceuta dhe Melilla, eksportuesi duhet t'i cekë ato qartë në dokumentin për të cilin bëhet deklarata, me anë të simbolit 'CM'.

(3) Këto indikacione mund të lihen anash nëse informatat gjenden në vet dokumentin.

(4) Në rastet kur eksportuesi nuk është i detyruar të nënshkruajë, përjashtimi nga nënshkrimi nënkupton edhe përjashtimin e emrit të nënshkruesit.

iii

Deklarata e furnitorit

Deklarata e furnitorit, teksti i së cilës është dhënë më poshtë, duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA E FURNITORIT

për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit tek Palët Kontraktuese të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale Pan Euro-Mediterrane të origjinës pa përfutur statusin preferencial të origjinës

Unë, i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga dokumenti i bashkëngjitur, deklaroj se:

1. Materialet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] janë përdorur në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] për të prodhuar këto mallra:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara ⁽¹⁾	Përshkrimi i materialeve të përdorura pa origjinë	Kreu i materialeve të përdorura pa origjinë ⁽²⁾	Vlera e materialeve të përdorura pa origjinë ⁽²⁾⁽³⁾
Vlera totale			

2. Të gjitha materialet tjera të përdorura në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse];
3. Mallrat e mëposhtme i janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] në pajtim me Nenin 13 të Shtojcës I dhe kanë përfutur vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara	Vlera totale e shtuar e përfutur jashtë [Cekeni emrin e Palëve Kontraktuese përkatëse] ⁽⁴⁾
	(Vendi dhe data)

(Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit, përveç emrit të personit që nënshkruan deklaratën, duhet të ceket me shkrim të qartë)

- (1) Kur fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme të mallrave ose mallrat të cilat nuk përfshijnë material pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull:

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti, varësisht se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

- (2) Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse është e nevojshme.

Shembuj:

Rregulli për veshjet e ish Kapitullit 62 thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga BE-ja që janë përfituar atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnizuesit e BE të përshkruajë në deklaratën e tij materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të ceket kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit nga kreu 7217 që e ka prodhuar atë nga shufrat e hekurit duhet të ceket në kolonën e dytë 'shufrat e hekurit'. Nëse ky tel duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, në kolonën e tretë duhet të ceket vlera e shufrave pa origjinë.

- (3) 'Vlera e materialeve' nënkupton vlerën doganore në kohën e importimit të materialeve të përdorura pa origjinë, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse].

Vlera e saktë për secilin nga materialet e përdorura pa origjinë duhet të jepet për njësi të mallrave të specifikuar në kolonën e parë.

- (4) 'Vlera totale e shtuar' nënkupton të gjitha shpenzimet e akumuluar jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse], duke përfshirë vlerën e të gjitha materialeve të shtuara atje. Vlera e saktë totale e shtuar e përfituar jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] duhet të jepet për njësi të mallrave të specifikuar në kolonën e parë.

iv

Deklarata afatgjatë e furnitorit

Deklarata afatgjatë e furnitorit, teksti i së cilës është dhënë më poshtë, duhet të bëhet në pajtim me shkrimet fundore. Megjithatë, shkrimet fundore nuk duhet të riprodhohen.

DEKLARATA AFATGJATË E FURNITORIT

për mallrat që u janë nënshtruar punimit ose përpunimit tek Palët Kontraktuese të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale Pan Euro-Mediterrane të origjinës pa përfituar statusin preferencial të origjinës

Unë, i poshtëshënuari, furnitor i mallrave që mbulohen nga dokumenti i bashkëngjitur, që i dorëzohen rregullisht ⁽¹⁾ deklaroj se:

1. Materialet e mëposhtme që nuk e kanë origjinën në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] janë përdorur në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] për të prodhuar këto mallra:

Përshkrimi i mallrave furnizuara ⁽²⁾	Përshkrimi i materialeve të përdorura origjinë	Kreu i materialeve të përdorura pa origjinë ⁽³⁾	Vlera e materialeve të përdorura pa origjinë ⁽³⁾⁽⁴⁾
Vlera totale			

2. Të gjitha materialet tjera të përdorura në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] për të prodhuar këto mallra e kanë origjinën në [cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse];
3. Mallrat e mëposhtme i janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] në pajtim me Nenin 13 të Shtojcës I dhe kanë përftuar vlerën e mëposhtme totale të shtuar:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara	Vlera totale e shtuar e përftuar jashtë [Cekeni emrin e Palëve Kontraktuese përkatëse] ⁽⁵⁾

Kjo deklaratë është e vlefshme për të gjitha dërgesat pasuese të këtyre mallrave të dërguara prej

në (6)

Marr përsipër të njoftojë (1) menjëherë nëse kjo deklaratë nuk është më e vlefshme.

(Vendi dhe data)
(Adresa dhe nënshkrimi i furnitorit; përveç emrit të personit që e nënshkruan deklaratën, duhet të ceket me shkrim të qartë)

- (1) Emri dhe adresa e klientit
- (2) Kur fatura, nota e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëngjitet deklarata ka të bëjë me lloje të ndryshme të mallrave ose mallrat të cilat nuk përfshijnë material pa origjinë në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë qartë dallimin e tyre.

Shembull:

Dokumenti ka të bëjë me modele të ndryshme të motorit elektrik të kreut 8501 që përdoret në prodhimin e makinave larëse të kreut 8450. Natyra dhe vlera e materialeve pa origjinë të përdorura në prodhimin e këtyre motorëve ndryshojnë nga një model në tjetrin. Modelet duhet të diferencohen në kolonën e parë dhe treguesit duhet të jepen në kolonat e tjera veçmas për secilin model për të bërë të mundur për prodhuesin e makinës larëse të bëjë një vlerësim të saktë për statusin e origjinës së këtij produkti, varësisht se cilin model të motorit elektrik ai përdor.

- (3) Treguesit e kërkuar në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse është e nevojshme.

Shembuj:

Rregulli për veshjet e ish Kapitullit 62 thotë që mund të përdoret filli pa origjinë. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Algjeri përdor materialet e importuara nga BE-ja që janë përfituar atje nëpërmjet thurjes së fillit pa origjinë, është e mjaftueshme për furnizuesit e BE të përshkruajë në deklaratën e tij materialin pa origjinë të përdorur si fill, pa qenë e nevojshme të ceket kreu dhe vlera e këtij filli.

Një prodhues i hekurit nga kreu 7217 që e ka prodhuar atë nga shufrat e hekurit duhet të cekë në kolonën e dytë 'shufrat e hekurit'. Nëse ky tel duhet të përdoret në prodhimin e një makine për të cilin rregulli cakton një kufizim për të gjitha materialet pa origjinë të përdorura në një vlerë të caktuar në përqindje, në kolonën e tretë duhet të ceket vlera e shufrave pa origjinë.

- (4) 'Vlera e materialeve' nënkupton vlerën doganore në kohën e importimit të materialeve të përdorura pa origjinë, ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse].

Vlera e saktë për secilin nga materialet e përdorura pa origjinë duhet të jepet për njësi të mallrave të specifikuar në kolonën e parë.

- (5) 'Vlera totale e shtuar' nënkupton të gjitha shpenzimet e akumuluar jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse], duke përfshirë vlerën e të gjitha materialeve të shtuara atje. Vlera e saktë totale e shtuar e përfituar jashtë [Cekeni emrin e Palës Kontraktuese përkatëse] duhet të jepet për njësi të mallrave të specifikuar në kolonën e parë.
- (6) Plotësoni datat. Periudha e vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit nuk duhet të kalojë normalisht 12 muaj, duke iu nënshtruar kushteve të vendosura nga autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata afatgjatë e furnitorit.